



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 6318/5 Prot

Fier më, 08/06 /2026

PROCESVERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 05.06.2026. Sot në sallën e mbledhjeve ora 11:00. Të pranishëm në mbledhje 31 këshilltarë.

Z.Melsi Bogdani

Të nderuar këshilltarë! Sot më datë 05.06.2026 fillojmë zhvillimin e mbledhjes jashtë radhës të Këshillit Bashkiak sipas kërkesës së ardhur nga kryetari i bashkisë me numër në protokoll 6389/1 datë 28.05.2026. Para se të fillojmë, i nderuar sekretar, unë si kryetar, por edhe shumë kolegë, më ka lindur shqetësimi për shpalljen e minutës së fundit të publikimit, të njoftimit të mbledhjes nëpër faqet e rrjeteve sociale të Këshillit Bashkiak. Të lutem një sqarim për këtë.

Z.Armando Çupa

Atëherë, sikurse jeni në dijeni, në qoftë se nuk jeni, po e ri-theksoj edhe njëherë, atëherë rrjetet sociale janë mirëmbajtur, janë krijuar dhe janë mirëmbajtur nga ana e zyrës së medias së Bashkisë Fier, për shkak se Sekretariati nuk ka specialist medias. Kam komunikuar dhe unë e kam vënë re këtë shqetësim, kam komunikuar me përgjegjësën e zyrës së medias, znj. Besa dhe më ka informuar që publikimi është bërë në ëeb-in e bashkisë ku sipas asaj është detyrimi ligjor i bashkisë për të publikuar njoftimet. Ëë, ëeb-i është, ëeb-i zyrtar i cili monitorohet edhe nga komisioneri i transparencës. Pjesa e rrjeteve sociale është për promovim dhe ajo gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë me leje. Kjo ka qenë arsyeja që është bërë me vonesë publikimi. Faleminderit."

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Atëherë kolegë këshilltarë, përpara se të kalojmë në procedurën normale të rendit të ditës, duke qenë se mbledhja e Këshillit Bashkiak datë 28.05 ishte mbledhja e parë në drejtimin e Këshillit Bashkiak si kryetar, pasi lexova me shumë kujdes procesverbalin e mbledhjes zbardhur nga sekretari i këshillit, vura re disa problematika, të cilat dua t'i ndaj me ju. Së pari, po i drejtohem, do të doja shumë të ishte në sallë, ish-kryetares së Këshillit Bashkiak, zonjës Antoneta Çunaj. E nderuar kolege këshilltare, në mbledhjen e kaluar, falë motivimit dhe


frymëzimit që kishit, në mbledhje, e keni marrë fjalën aq shumë herë sa unë si kryetar, kur kam qenë në pozicionin tuaj, nuk kam folur për tre vjet me radhë. Kjo, e dashur kolege, jo se nuk di të flasë, por sepse kam qenë koherent me grupin të cilin përfaqësojmë, unë dhe ti në këtë Këshill Bashkiak. Në rreth 340 vendime të marra nën drejtimin tuaj, vota ime si këshilltar ka qenë përputhje me fjalën dhe dakordësisë e grupin që përfaqësoj unë, ti dhe fjalës së kryetares së grupit që kemi pasur. Kështu dhe ju kolege, nga kjo mbledhje e në vazhdim, fjalën do ta merrni në përputhje me rregulloren e Këshillit Bashkiak. Së dyti, 5 apo 6 faqe të proces-verbalit të mbledhjes së kaluar, është një leksion që na bën zbatim të ligjit 139/2015 i cili është ky ligj i dashur koleg. Konkretisht, i nenit 53 Funksionimi i Këshillit Bashkiak. Në nenin 53 të Këshillit Bashkiak, i cili na u lexua me kujdes, pika 1 thotë: "Këshilli Bashkiak ushtron funksionet e tij nga data e konstituimit, sipas nenit 48 të këtij ligji, deri në krijimin e këshillit të ri pasardhës." Dy, mbledhjet e radhës së Këshillit Bashkiak zhvillohen si rregull, sipas përcaktimit që bën vetë këshilli, por jo më pak se një herë në muaj. Tre, këshilli mbledhet në çdo rast, është rasti konkret që jemi mbledhur sot, me kërkesën e kryetarit të bashkisë, me kërkesën me për shkrim të jo më pak se 1/3 e anëtarëve të tij dhe me kërkesën e motivuar të prefektit për çështje që lidhen me ushtrimin e funksioneve të tij. Thënë kjo, të dashur kolegë, ky ligj nuk ka vetëm këtë nen për zbatim. Ka dhe nene të tjerë, sikurse është neni 64 që thotë kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë. Dhe po citoj tre nga pikat: Kryetari i bashkisë ka këto kompetenca: Ushtron të gjitha kompetencat në kryerjen e funksioneve të bashkisë, me përjashtim të atyre që janë kompetenca vetëm e Këshillit Bashkiak. B, zbaton aktet e Këshillit Bashkiak. C, merr masa për përgatitjen e materialeve të mbledhjes së Këshillit Bashkiak, në përputhje me rendin e përcaktuar nga këshilli, si dhe për probleme që kërkon ai vetë. Në mënyrë rastësore, në mënyrë rastësore unë kam në dorë tre projekt-vendime. Vendim numër 91 datë 02/11/2020 të miratojë strukturën e sekretariatit me përbërje si më poshtë: Sekretari i Këshillit, 1 punonjës, ndihmës sekretar i këshillit, 1 punonjës. Ky vendim mban datën 02/11/2020. Me sa di unë, sepse kam qenë dhe nën-kryetar në legjislacionin e kaluar, ju sekretar keni qenë sekretar dhe përtej këtij legjislacioni. Është zbatuar ky, vendim i këshillit?

Z.Armando Çupa

Për aq kohë sa jam unë, sepse dhe unë jam në fund të vitit 2022, ose në fillim të vitit 2023 në këtë detyrë, ky akoma nuk ka gjetur zbatimin. Pra, siç e keni vënë re dhe ju, pranë Sekretariatit nuk ka akoma le të themi një punonjës ndihmës që t'jetë i atashuar pranë sekretarit.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Vendim numër 63 datë 30/05/2024 për emërtimin e një rruge me emrin "Spiro Lule". Emërtimi "Spiro Lule" sipas fragmentit të ardhur pas përcjelljes së këtij vendimi. Tani, ky vendim nuk është zbatuar dhe sipas, me sa kam mundësi unë në dijeni, dhe kjo nuk është e rëndësishme vetëm për vendosjen e një pllake 20x40 cm, por ka rëndësi të veçantë për familjarët dhe pasardhësit e "Spiro Lules". Kemi dhe një vendim numër 87 datë 23/09 për miratimin e programit buxhetor, më fal, për një ndryshim në VKM-në 139 datë 23/12/2024 për



miratimin e programit buxhetor afatmesëm të bashkisë P.B.A 2025-2027, dhe të numrit të përgjithshëm të punonjësve të bashkisë për vitin 2025 i ndryshuar si pasojë e ristrukturimit të administratës dhe të institucioneve vartëse të bashkisë. Me sa jam edhe për këtë në dijeni, ky vendim është zbatuar fare pak, ose është zbatuar në përqindje shumë të vogël. Kolegë, meqënëse ish-kryetarja i përmendi kolegëve Gjykatën Administrative në mbledhjen e kaluar, saqë më revoltoi edhe këshilltaren Buna Hoxha, i bëj me dije zonjës Antoneta Çunaj që dy nga këto vendime janë të firmosura nga vetë ajo, dhe nuk kanë gjetur akoma zbatim. Së treti, në mbledhjen e ardhshme secilit prej jush do t'i vendoset në tavolinë një libër i madh me titull "Rregullore për funksionimin e Këshillit Bashkiak". Për të kuptuar rëndësinë e zbatimit me korrektesë të kësaj rregulloreje, mjafton të lexojmë pikën tre "Baza Ligjore", ku është mbështetur hartimi i kësaj rregulloreje. Neni 3, baza ligjore, nuk do t'i lexoj të gjitha se janë 25 ligje që po janë, ku është mbështetur, por do lexoj pesë të parat. Baza ligjore kryesore ku është mbështetur hartimi i kësaj modeli rregulloreje është: Ligji 8417 datë 21/10/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ndryshuar". Ligji 8137 datë 31 për ratifikimin e konventës evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ligji për ratifikimin e konventës evropiane, Ligji, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar, Ligji për Vetëqeverisjen Vendore, Kodi i Procedurave Administrative dhe shumë 13, 14 ligje të tjerë. Si përfundim, kjo rregullore duhet të jetë busulla jonë, të nderuar kolegë dhe nuk ka gjykatë që na dënon apo na merr në shqyrtim, në qoftë se ne zbatojmë me rigorozitet rregulloren e Këshillit Bashkiak. Në këtë këshill merren vendime shumë të rëndësishme që kanë një impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve tanë, si në investime, në infrastrukturë, në shërbim social, në fushën e arsimit, në ndihma të ndryshme, në taksa te hapësirave publike etj. Dhe detyra jonë e përbashkët e të gjithëve në këtë sallë është të gjitha vendimet të jenë, në bazë të ligjit dhe në zbatim të Rregullores së Këshillit. Mbase unë si Kryetar nuk e kam përvojën shumë vjeçare në fushën juridike si ish-Kryetarja e Këshillit Bashkiak apo ndonjë koleg tjetër këtu në këshill, por për një gjë të jeni të sigurt, Ligjin dhe Rregulloren e Këshillit, që është e shkruar e zeza mbi të bardhë, e lexoj saktë, qartë dhe pastër. Ndjesë për kohën e marrë dhe shumë faleminderit që më dëgjuat. Tani kalojmë në miratimin e rendit të ditës.

Z.Endri Jaupaj

Po, Faleminderit!

Znj.Evis Sema

Nuk kishte duartrokitje për këtë?

(Duartrokitje...)

Z.Endri Jaupaj

Po e meriton vërtet duartrokitjen e the shumë mirë.



Znj.Evis Sema

Më fal të bëjë një pyetje?

Z.Roel Zoga

Kryetar, duket sikur deri tani nuk është zbatuar ligji këtu me këto?

Znj.Evis Sema

Po pra me këto që thatë, duket sikur është zbatuar ligji.

E para dhe e dyta, me leje kryetar, kam vetëm një pyetje: se po etiketohemi kështu të mirë dhe të këqinj. Ju lexuat tre vendime që i ka marrë ky Këshill, një të 2020-s për sekretariatën dhe dy të tjera. Ajo që nuk kuptoj unë është, këshilli e ka bërë detyrën e tij, e ka marrë vendim marrjen për ato vendime, përse erdhën sot ato? Për çfarë nuk unë kuptua, përse erdhën sot ato të 2020-Nuk e kuptova, e them sinqerisht ?

Z.Melsi Bogdani

Ok. Atëherë unë e citova që na u bë një leksion mbi zbatimin e ligjit, dhe unë e citova.

Znj.Evis Sema

Të lutem, të lutem, vetëm një gjë, meqenëse mora leje për ta thënë. Më duket sikur kjo e ka kaluar atë, atë, a- funksionim a ku di gjë unë, megjithë këto që po.... Mua mu duk deri në këto momente, sikur isha në një seancë gjyqi dhe jo në një mbledhje Këshilli. Jo ligj, jo rregullore, të tëra, kur ndërkohë, secili prej nesh, në të gjithë, që nga data e fillimit deri në sot, nuk e di që të ketë shkelur ndonjëherë rregulloren, ligjin e të tëra.

Z.Melsi Bogdani

E citova, e citova

Znj.Evis Sema


Për ato që kanë qenë pika të rendit të ditës ose për vendim-marrjet që keni marrë.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë Këshilli e ka të domosdoshëm një punonjës në sekretariatën e Këshillit. Unë citova vendimin që nuk është zbatuar akoma.

Znj.Evis Sema

Ç'problem ka Këshilli në këtë rast...Përse i erdhi Këshilli kjo? Përse i erdhi Këshilli ? Këshilli e ka marrë një vendim marrje dhe deri këtu është kompetencë e Këshillit.



Z.Endri Jaupaj

I nderua Kryetar, do drejtosh mbledhjen apo do merresh duke i dhënë llogari një këshilltareje ? S'e kuptoj këtë unë ? Bëhu tek të mirët dhe ti se e the edhe vetë. Ti e di ku je, ti e di ku do jesh ? Dmth ti je tek të mirët, se them që na ke ndarë ? Ti ku je ti, ti ku je ?

Znj.Evis Sema

Jo,jo mos evidentoni thashë, të mirë... pro, kundra.

Z.Endri Jaupaj

Jo, ti ku je? Jo, ti ku je? Ti...

Znj.Brunilda Hoxhaj

Nuk ka asgjë të keqe përsëritja e rregullave, përsëritja është mëma e dijes. Shumë mirë bën që i përsëri rregullat, sepse shumë i harrojnë rregullat dhe ligjet. Asgjë të keqe s'ka.

Z.Melsi Bogdani

Endri, o Endri të lutem!

Znj.Evis Sema

Ne jemi mbledhur një mbledhje Këshilli dhe kemi një rend dite, pa kaluar miratimin e rendit të ditës, pa kaluar pikat, madje ne Rregulloren e këtij Këshilli në mbledhjen e kaluar, të cilën e kishim thirrur mbi një Rend Dite të miratuar që në fillim dhe 5 pika të rendit të ditës ne nuk i kaluam. Që herën e parë e keni shkelur Rregulloren e Mbledhjes së Këshillit.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë e nderuar këshilltare, e nderuar këshilltare. Në fjalën time, ju kërkova ndjesë, e para, për kohën dhe ju kërkova falje për pjesën e fjalës sime. Po Niku, se do të hyjë në procedurën normale.

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë përshëndetje të gjithëve! Siç kolegët dhe kelegia, u lejuan të shprehnin mendimi i tyre dhe unë kam të drejtën time të shprehë mendimin për aq sa dëgjova . Në radhë të parë të përgëzojë ty kryetar, për këtë rezume që the, sepse siç jemi të gjithë dëshmitarë mbledhja e kaluar doli jashtë formatit etik, për shkak të sjelljes së pa-motivuar, që unë nuk e kuptova të disa kolegëve këtu dhe përtej zgjatje të fjalës së Kryetarit të Bashkisë, kur flasim për një kryetar i Bashkisë, në një mënyrë dhe në një formë krejtësisht të pa-nevojshme duke arritur vetë deri në një nivel sa nga kolegja Buna Hoxha ju tërhoqi vëmendje, duke i thënë po kaloni në intimidim ose në kërcënim të këshilltarëve. Të falënderoj ! Fjalën e ndoqa me shumë vëmendje, jam



plotësisht dakord me të gjitha ato që the. Për hir të së vërtetës, kam qenë po unë që i kam ngritur këto probleme në vite, këto tre vite me radhë. Nën drejtimin e koleges Antoneta Çunaj, janë evidentuar shumë shkelje në drejtimin e Këshillit Bashkiak këto 3 vjet. Fakti që e vërteton këtë është dorëheqja e saj e përvokueshme dhe kërkesa e grupit të Partisë Socialiste dhe çdo gjë tjetër që thuhet këtu, tani, është kakofoni dhe zhurmën, të lutem, vazhdoni në rendin e ditës.

Znj.Evis Sema

Nuk ka projektvendime të dërguara në Prefekturë që të jenë kthyer. Nqs një projektvendim vjen mbrapsht nga Prefektura, atëherë do të thotë që nuk është zbatuar në rregull ligji.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, faleminderit Niku.

Pika e parë e Rendit të Ditës.

Miratimi i rendit të ditës.

Z.Melsi Bogdani


Atëherë në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja A të ligjit 139/2015, për vetëqeverisjen vendore i ndryshuar dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak, nenit 61, si dhe kërkesës së ardhur nga kryetari i Bashkisë, protokolluar me numër 6318/1 datë 28.05.2026, ju njoftojmë për thirrjen e mbledhjes jashtë radhe të Këshillit Bashkiak Fier në sallën plenare të Këshillit ditën e premte datë 05.06.2026 në orën 11:00 me këtë rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.05.2026.
3. Projektvendim: "Për miratimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor në pronësi publike të Bashkisë Fier, për shtrirjen e linjës së ujësjellësit Patos".
4. Projektvendim:" Për detajimin e përdorimit të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile".
5. Projektvendim:" Për miratimin e planit të arsimit para-universitar 2026-2030 të Bashkisë Fier".
6. Projektvendim: "Për miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2025 të Bashkisë Fier dhe institucioneve mbartëse".
7. Projektvendim:"Për miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2025 të Shoqërisë Apollonia, Apollonia Sh.A".

Kush është dakord me rendin e ditës?Të gjithë pro.Dhe sa ishte korumi në sallës?

Z.Armando Çupa

Aktualisht në sallë janë 28 këshilltarë. Ishin 29 po këshilltari Roel Zoga u largua.



Z.Melsi Bogdani

Pra 28.

Z.Arnando Çupa

Po 28.

Z.Melsi Bogdani

Kundra s'ka, abstendim s'ka, miratohet.

Pro 28 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e dytë e Rendit të Ditës.

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.05.2026.

Z.Melsi Bogdani

Edhe këtu i nderuar sekretar, të bëjmë një zbatim të rregullt të rregullores së këshillit, e cila ka të përcaktuar në nenin 67, mos gabofsha, që tre anëtarët e Këshillit, unë edhe ti, tre anëtarët që do zgjidhen në seancën plenare, unë dhe ju që jeni bëni zbardhjen e proces-verbalit do të kemi të drejtën për të firmosur proces-verbalin pas zbardhjes. Që nga kjo mbledhje do kalojë në famologji të plotë edhe kjo pjesë e Rregullores.

Atëherë nga Partia Socialiste, meqënëse mungon kryetari i grupit, unë do të propozoj Elvi Dakën për firmosjen e... Po.

Z.Kreshnik Dapi

Për grupit tim unë, Kreshnik Dapi.


Z.Melsi Bogdani

Dhe Rrapi ?

Z.Rrapi Gjika

Unë.

Z.Melsi Bogdani



Dhe Rrapi Gjika. Atëherë, kalojmë... kalojmë në miratimin e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë 28.05.2026, kush është.. Ok ?

Z.Arnando Çupa

Procesverbali është shpërndarë elektronikisht dhe është firmosur nga të gjithë.

Z.Melsi Bogdani

Të gjithë dakord. Miratohet.

Pro 28 vota

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e tretë e Rendit të Ditës.

Projektvendim :“Për miratimin e raportit tekniko-ekonomik për dhënien në përdorim të fondit pyjor në pronësi publike të Bashkisë Fier për shtrirjen e linjës së ujësjellësit Patos”.

Z.Melsi Bogdani

Ekzekutivi...Hajde këtu, merr fjalën të lutem.

Z.Erald Qirjo

Përshëndetje të gjithëve! Ky projektvendim ka të bëjë me kalimin e linjës për ndërtimin e ujësjellësit të ri që po bëhet në Patos dhe një pjesë e linjës kalon në një sipërfaqe të tokës pyjore, e cila është në pronësi të Bashkisë Fier. Ky projekt ka qenë i miratuar dhe nga ana juaj para tetë muajsh, por për shkak të vonësive që na kanë ardhur nga ASHK-ja për nxjerrjen e certifikatave të pronësisë të ngastrave pyjore, po e kalojmë përsëri në Këshill për të kaluar këtë këtë linjë. Dhe sipërfaqja do t'i jepet në përdorim në formën e qirasë, sipas ligjit dhe udhëzimeve që janë në fuqi, për një periudhë tre mujore e cila është propozuar nga vetë Bashkia Patos për vazhdimin e punimeve. Për më tepër, nuk e di kush ka ndonjë pyetje. Linja, e theksoj, kalon në linjën e vjetër që ka qenë, kalon paralel me të, nuk preken as bimë të larta, as bimë të ulëta për prerjen e tyre, thjesht është hapja e rrugës. Ajo pjesë e rrugës.

Z.Melsi Bogdani

Ka ndonjë paqartësi për këtë pjesë para se të dalim në votë ? Atëherë, e hedhim në votë.

Znj.Bruna Hoxhaj



S'e ke inxhinierin sot.

Z.Melsi Bogdani

Të gjithë pro. Kundra s'ka, abstendim s'ka, miratohet.

Pro 28 vota

Kundra s'ka.

Abstënim s'ka

Miratohet.

Z.Erald Qirjo

Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Erald shumë faleminderit !

Pika e katërt e Rendit të Ditës.

Projekt-vendim: "Për detajimin për përdorimi të fondit të kushtëzuar për mbrojtjen civile".

Z.Melsi Bogdani

Pranvera?

Znj.Pranvera Cina

Faleminderit! Ky projektvendim vjen në bazë të transferës së kushtëzuar, miratuar me buxhet shteti të vitit 2026. Fondi i alokuar për bashkinë Fier është në vlerën 9.716.728 lekë. Bazuar në VKM 414 të vitit 2021 të ndryshuar, pika 3.1 e nenit 41 ku shprehet se 60% deri në 100% të fondit të dedikuar për mbrojtjen civile mund të përdoret për akordimin e ndihmës financiare për familjet, banesat e të cilave janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore. Propozojmë që ky fond të përdoret për likuidimin e pjesshëm të familjeve të dëmtuara nga përmbytjet e muajit janar 2026."

Z.Melsi Bogdani

Keni ndonjë pyetje të nderuar këshilltarë? Kush është dakord ? Të gjithë dakord. Miratohet.

Kundra s'ka, abstënim s'ka, miratohet. Pranvera shumë faleminderit !

Znj.Pranvera Cina

Faleminderit !

Z.Armando Çupa

Kryetar është 1 kundër.

Z.Melsi Bogdani

Kush ishte kundër ? A më fal se pashë. 27 pro, 1 kundër.

Pro 27 vota

Kundra 1 votë.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Pika e pestë e Rendit të Ditës.

Projekt-vendim:”Për miratimin e planit të arsimit parauniversitar 2026-2030 të Bashkisë Fier”.

Z.Melsi Bogdani

Mirela je ti për këtë pikë ?

Znj.Mirela Pitushi

Po. Mund të flasë që këtu ?

Z.Melsi Bogdani

Jo, jo. Këtu, këtu.

Z.Agron Profka

Aty ku të thotë kryetar.

Z.Melsi Bogdani

Jo, jo e ka të përcaktuar edhe këtë Rregullorja, nuk ka lënë gjë pa përcaktuar.

Znj.Mirela Pitushi

Përshëndetje kolegë të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak! Ky dokument është një dokument strategjik që bazohet mbi strategjinë e arsimit parauniversitar 2026-2030, është për vazhdimësinë e arsimit në Bashkinë e Fierit. Për këtë nga Kryetari i Bashkisë u ngrit një grup pune nga tre përfaqësues të grupit teknik, dy anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe në mbikëqyrje nga unë si nënkryetare. Ky, ky plan hartohet për zgjerimin e rrjetit të çerdheve dhe kopshteve për të përfshirë sa më shumë fëmijë në arsimin parashkollor, masat për parandalimin e braktisjes

10

shkollore, trajnime të vazhdueshme për mësues për metodologjinë e tyre bashkëkohore në mësimdhënie, pajisjen e shkollave me laboratore, mjete didaktike moderne në lidhje me qëndrueshmërinë dhe internetin. Pajisjen e shkollave me laboratore e thashë, parashikimi i fondeve në buxhetin vendor, krijimi i rrjetit të bashkëpunimit midis institucioneve arsimore. Mbi këtë është edhe një buxhet. Ky buxhet është financohet nga ë, nga të tretët, sigurohet përmes të ardhurave vendore dhe transfertave nga buxheti i shtetit. Jam e hapur për çdo pyetje që mund të më drejtohet."

Z.Endri Jaupaj

Sa është buxheti ? Nqs flasim për shifra ?

Znj.Mirela Pitushi

Nuk flasim për shifra, sepse këto janë fonde që thithen nga donatorë, nga të tretë, nga buxheti vendor. Pra, ne kemi sot, nga ju miratohet një plan vendor arsimor për ato pika që unë thashë dhe buxheti pastaj thithet nga të tretët, nga planet buxhetore nga Ministria e Pushtetit Vendor edhe më gjerë. Është një buxhet që thithet nga të tretët.

Z.Endri Jaupaj

Po e ke. E ke e ke shumë të shkurtuar.

Znj.Mirela Pitushi

Do jetë për arsimin parauniversitar në të gjithë Bashkinë Fier.

Znj.Brunilda Hoxhaj

Kush janë anëtarët e Këshillit që janë në grupin e caktuar nga Kryetarin i Bashkisë që punojnë në këtë ?

Znj.Mirela Pitushi

Është Zana Numani dhe për dijenin time është edhe një zyshë që është nga...

Z.Kreshnik Dapi

Floreta Gjino,

Znj.Brunilda Hoxhaj

Floreta? Sepse e kishit përcaktuar aty nga komisioni jonë.

Znj.Mirela Pitushi

Është komision nga Këshilli Bashkiak dhe unë si nënkryetare është një komision...

Znj.Brunilda Hoxhaj

Prandaj doja të sigurohesha që ishin këto të dyja , sepse dhe ne si komision, bashkë me këtë zonjën tjetër këtu këto emra kishim caktuar.

Znj.Mirela Pitushi

Po.

Z.Melsi Bogdani

Po zyshe ?

Znj.Yllka Sheshi

Kam diçka të them të drejtën, kam dashur ta lexoj materialin, por ka qenë e pamundur në bazë të materialit që na ka ardhur në mënyrë elektronike, sepse vumë re, në mbledhjen që ne vajtëm, që e kemi bëmë para-praktisht për dhënien e mendimin të komisionit, vumë re që atje ishte një skaner që nuk mbante dot ngarkesën e duhur, për të ardhur materialit i saktë. Dhe, të them të drejtën, është edhe një pjesë për shtimin e punonjësve social dhe psikologëve në arsimin para-universitar...

Znj.Mirela Pitushi

Po

Znj.Yllka Sheshi

Dhe herën e kaluar me të drejtë kolegu jonë ngriti shqetësimin që një ekip, Apollonia që ka, qenë për ne fierakët nuk është gjë e mirë, investohet aq shumë dhe lihet Sekretari i Këshillit Bashkiak me një skaner që nuk arrin dot në mënyrë elektronike të na japë materialet...

Znj.Mirela Pitushi

Pjesa teknike e Këshillit Bashkiak nuk është përgjegjësi e planit vendor arsimor.



Znj.Yllka Sheshi

Unë, të them të drejtën do të flisja më shumë për punonjësit social. Ne e dimë shumë mirë...

Znj.Evis Sema

Qenka ankuar Sekretari sot ?

Znj.Yllka Sheshi



12



Jo jo unë u ndjeva keq në mbledhjen e kaluar, sepse nuk kaluam dot pikat që duhet, sepse do ta ngrija që në mbledhjen e kaluar...

Z.Melsi Bogdani

Yllka të lutem, të lutem, konkludo për pikën !

Znj.Yllka Sheshi

Po, tani, me punonjësit social që duhet të jenë dhe për mua duhet të jenë funksional që jo të jetë një psikolog për dy-tre shkolla, sepse nuk arrin dot të menaxhojë, ne e dimë shumë mirë fëmijët sot kanë probleme, probleme psikologjike vërtet u janë shtuar, që duhet të jenë, ëh duhet të jenë pjesë e strukturës arsimore, të jenë funksional që jo të marrin në letra, por të bëjnë punën realisht. Sepse shohim që në këto, ka shkolla që vërtetë ekzistojnë, por për mua nuk bëjnë punën që duhet. Kjo duhet mbikëqyrje pak më e madhe që këta fëmijë që kanë këto problematika të gjejnë rrugën e shpëtimit . Pra mua më vjen mirë që po, të jetë një fond i tillë, këtu thoshte edhe për fëmijët romë, se thashë, nuk e kam lexuar dot materialin, vetëm nga kjo problematikë. Prandaj mirë është që këtu të vijë në ndihmë si çerdheve, që mos të jenë, të bombardohen një çerdhe me ose një kopsht me 30 e ca fëmijë, ku një edukatore nuk i mban dot, flasë të rritet numri, por mbi të gjitha dhe psikologë që të mos jetë një i tillë, që të kalojë një psikolog në dy-tre shkolla. Për mua është thjesht, ne kemi psikologë por nuk i shikojmë, por kush shkollë. Madje ka shkolla që s`kanë fare, që është akoma më keq.

Z.Melsi Bogdani

Yllka konkludove tek pyetja që të marrësh përgjigje ?

Znj.Yllka Sheshi

Thjesht dua të di, me një fjalë si është menduar për psikologët, se thashë këtu doja, për futjen e punonjësve social dhe psikologëve nëpër shkolla në sistemin arsimor parauniversitar edhe cikli i lartë i mesëm ?

Znj.Mirela Pitushi

Fortë e nderuar anëtare e Këshillit Bashkiak. Për këtë u bë një konsultim publik që u thirrën grupet e interesit dhe njëkohësisht është bërë dhe një shkresë për të ardhur edhe anëtarët e Këshillit Bashkiak. Për sa i referuar pyetjes tuaj, janë të ndara, punonjësi social, psikologu dhe punonjësi i asistuar për personat me aftësi ndryshe, janë të ndara. Psikologu merr në shqyrtim pjesën e gjendjes shoqërore të fëmijëve në një plan të vetmin, të detajuar. Ai mund të mbulojë një shkollë, dy shkolla, është pjesë e planit të tij arsimor. Kurse pjesa e asistenti për personat me aftësi ndryshe është një për një fëmijë. Dhe këtë ne e kemi përcaktuar edhe tek hartimi i planit që është këtu. Punonjësi social, pastaj është tjetër gjë.

Znj.Yllka Sheshi

13

Dhe pspikologët. E di për këtë që është një mësues vetëm për këtë sepse e thashë unë jam pjesë e arsimit dhe janë, por që të hedhim ne ide, si Këshill.

Znj.Mirela Pitushi

Po pra ishit të ftuar te konsultimi publik që kemi bërë dhe ka qenë e pranishme anëtarja juaj dhe mbikëqyrësja Zana Numani ka qenë prezent.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit Mirela! Ka ndonjë merak para se ta hedhë votë ?

Z.Endri Jaupaj

I vetmi merak që kam, ishte një projekt-vendim që është katër vite dhe do të doja nga ju që ta zgjasni pak më shumë pjesën e punës tuaj. Në qoftë se do ishte mundur, por lëmë për herës tjetër. Një projekt-vendim që e keni mbrojtur vetë, e keni rehatuar vetë, duke se po flasim për arsimin parauniversitar që është goxha i rëndësishëm dhe duhet të luftojmë fort aty, dhe me fonde dhe me të gjitha, do të doja herës tjetër të zgjateshit pak më shumë.

Znj.Mirela Pitushi

Jo, unë jam gati dhe të flasë edhe për pjesën e monitorimit që është e ndarë në dy grupe...

Z.Melsi Bogdani

Mirela, Shumë faleminderit!

Z.Endri Jaupaj

Në rregull, e mbyllim, e mbyllim. Në parim jam dakord.

Znj.Mirela Pitushi

Faleminderit juve!

Z.Melsi Bogdani

E hedhim në votë Kush është dakord?Kundra ? Rrapi nuk ta pashë kartonin ?

Z.Rrapi Gjika

Jam kundra.

Z.Melsi Bogdani

29 vota pro, 1 kundër, miratohet.

14

Pro 29 vota

Kundra 1 votë.

Abstenim s'ka

Miratohet.

Znj.Brunilda Hoxhaj

Zoti kryetar, më falni, përpara se të kalojmë tek pika tjetër, kush i bën njoftimet për këto dëgjuesat publike? Sepse këtu s'ka marrë asnjë njoftim për çfarë do lloj dëgjese që është bërë deri tani.

Z.Melsi Bogdani

Do t'i drejtohem ekzekutivit... do t'i drejtohem ekzekutivit të marrim përgjigje në fund, në fund të...

Z.Agron Profka

Për dëgjuesat publike është Kryetari i Rajonit që i njofton të tërë.

Znj.Brunilda Hoxhaj

Dakord. E mora përgjigjen, faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Kalojmë në pikën gjashtë.

Pika e gjashtë e Rendit të Ditës.

Projekt-vendim: "Për miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2025 të Bashkisë Fier dhe institucioneve mbartëse".

Z.Melsi Bogdani


Pranvera?

Znj.Pranvera Cina

Po

Z.Melsi Bogdani

Tani ne e kemi materialin, por shkurtimisht, mbi pasqyrat që të kemi informacion qoftë për mediat, por edhe për publikun.



Znj.Pranvera Cina

Po, shkurtimisht po shpjegoj domethënë vlerat. Aktivet. Total i aktiveve në fund të vitit ushtrimor paraqitet në vlerën 12 miliardë 158 milionë e 353 mijë lekë, nga të cilat 76% e zënë aktivet afatgjata dhe 24% aktivet afatshkurtër. Struktura e aktiveve tregon se pjesën kryesore të tyre e zënë aktivet afatgjata, të cilat përfaqësojnë pasuritë e paluajtshme, infrastrukturën publike, investimet dhe asetet të tjera në administrim të bashkisë. Aktivet afatshkurtër përfaqësojnë mjete monetare, llogari të arkëtueshme dhe elementë të tjerë qarkullues. Detyrimet. Detyrimet paraqiten në vlerën 1 miliard e 543 milion e 779 mijë lekë, ku përfshihen: detyrime ndaj furnitorëve, detyrime për paga dhe sigurime shoqërore, detyrime të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, dhe niveli i detyrimeve vlerësohet i kontrolluar dhe në përputhje me kapacitetin financiar të bashkisë dhe institucioneve të varësisë për përmbushjen e tyre. Fondi i konsoliduar në vlerën 11 miliardë 419 milionë e 573 mijë, më falni 11 miliardë e 414 milionë e 573 mijë lekë përfaqëson vlerën neto të aktiveve pasi është zbritur detyrimi i amortizimit. Bilanci i konsoliduar është përgatitur në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet e raportimit financiar të sektorit publik, bazuar në të dhënat e raportuara nga bashkia dhe institucionet e varësisë. Të ardhurat totale të realizuara për vitin ushtrimor 2025, arritën në vlerën 6 miliardë 60 milionë e 344 mijë lekë, duke përfshirë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifatat vendore, të ardhurat nga asetet dhe qiratë dhe transfertat e pakushtëzuara dhe të kushtëzuara nga buxheti i shtetit. Realizimi i të ardhurave dëshmon për përmirësimin e administrimit fiskal, rritjen e nivelit të arkëtimit dhe forcimin e mekanizmit të mbledhjes së detyrimeve vendore. Shpenzimet janë realizuar në vlerën 4 miliardë 858 milionë e 875 mijë lekë. Struktura e tyre përbëhet nga shpenzime për personel, shpenzime operative, transferta dhe mbështetje sociale, investime kapitale. Shpenzimet janë realizuar në funksion të ofrimit të shërbimeve publike, përmirësimit të infrastrukturës dhe përmbushjes së objektivave në zhvillimin vendor. Nga krahasimi i të ardhurave me shpenzimet, rezulton një tepriçë financiare prej 1 miliard e 234 milionë e 16 mijë e 890 lekë, e cila tregon se të ardhurat e realizuara kanë qenë më të larta se shpenzimet e kryera gjatë periudhës raportuese. Ky tregues dëshmon për një administrim të kujdesshëm të fondeve publike dhe një nivel të mirë të realizimit të të ardhurave. Nqs doni të vazhdojë më tej.

Z.Melsi Bogdani

Jo.

Znj.Pranvera Cina

Faleminderit !

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, Komisioni u mbledh për këtë pikë ?

Znj.Erlinda Llupi



16



Përshëndetje! Komisioni u mbledh. E kalojmë për miratim në Këshill, duke nxjerrë disa problematika kryesore. Atëherë, bllokimi i konsolidimit nga Ujësjetllësit Fier. Shoqëria Rajonale e Ujësjetllësit Fier, nuk ka dorëzuar pasqyrat financiare për vitin 2025, për pasojë të gjitha llogaritë e saj figurojnë me vlerë zero në bilancin e konsoliduar të bashkisë. Duke cënuar rëndë saktësinë e të dhënave totale të asetëve pa arkëtueshme. Dy. Paradoksi i detyrimeve të prapambetura. Ndërmjet faktit që bashkia ka një gjendje shumë të fortë mjesh monetare, mbi 1.3 miliardë lekë likuiditet, institucione si Qendra e Kulturës mbartin ende rreth 32 milionë lekë detyrime të tjera të trashëguara për vitet. Gjithashtu janë konstatuar fatura investimesh që kanë kaluar afatin ligjor prej 60 ditësh për likuidim, debitor të humbur dhe asetet të patransferuara. Qendra e Arsimit mban ende në bilanc debinë e nxënësve të konvikteve, që nga vitet 2015-2017, për të cilët nuk ka asnjë informacion ose mundësi arkëtimi.

Paralelisht, investimet e reja kapitalesh të kryera janë mbajtur në bilancin e aparatit të bashkisë, në vend që të kalojnë menjëherë tek ndërmarrjet që I menaxhojnë më terren. Pyetja jonë është : Ju jeni shprehur që bilanci është i konsoliduar, por a mund të quhet bilanc i konsoliduar, pa u depozituar pasqyra financiare e Ujësjetllësit Fier ? Me mbi 1,3 miliard lekë gjendje monetare të lirë cilat janë pengesat administrative që lejojnë mbajtjen e borxheve të vjetra apo kalimin e afateve 60 ditore të faturave ? Faleminderit !

Znj.Pranvera Cina

Faleminderit ! Përsa i përket shoqërisë rajonale të Ujësjetllës Kanalizimeve Sha Fier, ka dorëzuar pasqyrat financiare më datë 28.05.2026, e protokolluar pranë Bashkisë Fier me Nr.6768 Prot, por nuk e kemi përfshirë në këtë bilanc të konsoliduar për arsye se nuk ka ardhur brenda afatit të përcaktuar, si dhe jemi në pritje të përfundimit të procedurave në degën e Thesarit, me të cilën bëhet edhe akt rakordimi dhe bëhet mbyllja e të gjithë llogarisë, llogarive ekonomike të shoqërisë. Dhe për këtë shoqëri do të futemi në një mbledhje të ardhshme për miratimin e pasqyrave të Ujësjetllës Kanalizimeve Sha.

Znj.Erlinda Llupi

Cili është problemi që nuk është bërë gati në kohë bilanci ?

Znj.Pranvera Cina

Bilanci i shoqërisë Ujësjetllës Kanalizimeve ?

Znj.Erlinda Llupi

Po.

Znj.Pranvera Cina

Ata e kanë përfunduar pjesën e bilancit të Sha-ve, ndërkohë që ne kërkojmë raportim me degën e Thesarit, me veprimet që ata kryejnë me degën e Thesarit, do me thënë me institucionin ku ne

17

kryejmë veprimet financiare dhe rakordojnë. Dhe jemi në pritje të dokumentacionit të plotë për ta përfshirë në bilancin e konsoliduar.

Z.Kreshnik Dapi

Kryetar me leje ?

Znj.Pranvera Cina

Të përfundoja ?

Z.Melsi Bogdani

Se ka edhe pyetjen e dytë. Po ...

Znj.Pranvera Cina

Për sa i përket detyrimeve të drejtorisë së Artit dhe Kulturës apo te detyrimeve të institucioneve të tjera të prapambetura nuk është problem tek likuiditeti por është tek mungesa e dokumentacionit financiar të plotë në mënyrë që të bëhet ekzekutimi i tyre pagesave. Dhe këto vazhdojnë të qëndrojnë në bilanc deri në momentin që të ketë një raportim. Dhe për sa i përket debitorëve të konvikteve i përkasin një periudhe shumë të hershme. Ndërkohë që është bërë dhe e pamundur gjetja e debitorëve, njoftimi i tyre dhe arkëtimi i këtij detyrimi. Po për efekte ligjore do vazhdojnë të mbeten si debitorë në bilanc."

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit Pranvera, kush e do fjalën? Po, Niku!

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë me lejen tënde Kryetar , unë dua... kam përgatitur edhe unë një fjalë me disa konstatime të gjetura tek të dyja materialet, që na janë vënë në dispozicion, Bilanci dhe Relacioni përkatës. Do ta lexoj deri në fund. Disa gjetje përkohë me gjetjet e kolegës. Për hir të së vërtetës, në Komisionin e Ekonomisë, kjo pikë ka dështuar, nuk është miratuar. Unë dhe z. Arben Çuko kemi votuar kundër, ndërsa nga dy kolegë të tjerë është votuar pro. Dmth Komisioni nuk e ka miratuar. Pse nuk e ka miratuar do jua rendis me radhë, në fjalinë time të lutem, më ndihmon të mos kemi ndërhyrje ose mbivendosje.

Z.Melsi Bogdani

Sa më shkurt Niku, sa më konçiz ?

Z.Kreshnik Dapi

18

Ok. Pikë së pari për ta kuptuar kolegët që nuk merren me ekonominë, dhe qytetaret që na ndjekim. Ky është një nga dokumentat më të rëndësishëm të Bashkisë. Të mos them më i rëndësishmi ! Dhe për një ironi të fatit, tek ajo kritika që u hodh në mbledhjen e kaluar i bëj thirrje sidomos këshilltarëve që nuk kanë formim dhe njohuri për ekonominë, por për fusha të tjera të kenë kujdes sepse ky bilanc në formën që na ka ardhur ligjore dhe në përmbajtjen e tij ka probleme serioze që mund të na çojnë në përgjegjësi penale. Më poshtë vijon një analizë e hollësishme e relacionisht të dorëzuar e ndarë në katër shkalla kryesore, konceptualja, menaxhuesja, financiare dhe ligjore. Gabimet e dobësitë konceptuale të relacionit janë: Pika më kritike në aspektin konceptual është trajtimi i shoqërisë rajonale të ujësjellësit kanalizimeve sha Fier si... ku drejtorja pranon se meqenëse kjo shoqëri nuk ka dorëzuar pasqyra, llogaritë e saj në bilancin e konsoliduar janë paraqitur në vlerë zero. Ky veprim dhunon vetë konceptin e konsolidimit. Bilanci i konsoliduar ka për qëllim të bashkojë të gjitha entet nën juridiksion për të dhënë një pamje të plotë dhe të saktë. Vendosija me vlerë zero për një nga ndërmarrjet më të mëdha publike e bën gjithë dok umentin të pasaktë dhe të pashfrytëzueshëm për vendimmarrje. Deformimi i parimit të ndarjes së periudhave. Investimet e realizuara gjatë vitit 2025, siç janë rikonstruksione shkollash, rrugë, rrjete të ujësjellësit, kanalizimeve dhe ndriçues fotovoltaike janë mbajtur në bilancin e aparatit qendror të Bashkisë. Relacioni specifikon se transferimi i tyre tek ndërmarrja vartëse që i administrojnë realisht, do të bëhet gjatë vitit 2026. Kjo shtyrje artificiale deformon llogaritjen e amortizimit dhe kostove reale, për vitin ushtrimor 2025 në nivel ndërmarrje. Gabime dhe dobësi në menaxhim. Mungesa e autoritetit dhe kontrolli mbi ndërmarrjet vartëse vërtetohet që nga momenti që drejtorja e Financës i është drejtuar Ujësllësit me një shkresë urgjente vetëm më 28 prill 2026, Kërkesë urgjente për dorëzimin e pasqyrave financiare, thotë shkresa, dëshmon për një dështim të plotë të monitorimit menaxhues gjatë gjithë vitit. Administrata ka pritur fundin e prillit për të kuptuar që një ndërmarrje kyçe nuk ka depozituar asgjë në Thesari. Menaxhim Kaotik I Debitorëve në Llogari pa Dokumentacion. Relacioni pranon se në Drejtorinë e Artit dhe Kulturës ka vlera të paarkëtuara ndër vite, të cilat nuk janë të shoqëruara me asnjë dokumentacion origjinal, listë debitorësh apo procesverbal. Pranohet hapur se “po punohet për gjetjen e origjinës së lindjes së këtyre detyrimeve”. Ky është pranim i një administrimi të dobët kontabël ndër vite. Zvarritja e Borxheve të Këqija pa Ndjekje Ligjore . Te Qendra Ekonomike e Arsimit (QEA) mbarten ende si “debitorë” fëmijë të larguar nga kopshtet/çerdhet ose nxënës konviktet të viteve 2015-2017. Menaxhmenti pranon se nuk ka informacion për vendbanimin e tyre, por vazhdon t’i mbartë këto shifra në bilanc në vend që të ndiqte procedurat e fshirjes ligjore (ërite-off) ose të ekzekutimit. Regjistrime të Gabuara të Admituara. Në material pranohet shprehimisht një gabim teknik: “Është ngarkuar gabimisht shuma prej 501,564 lekë në llogarinë 434.2”. Çdo gabim material që pranohet në relacion tregon mungesë të rakordimeve të rregullta përpara mbylljes së llogarive. Menaxhim Financiar nën Presionin e KLSH-së. Relacioni specifikon se llogaritja e amortizimit për aktivet afatgjata është bërë “në zbatim të rekomandimit nr. 1.1 të lënë në raportin përfundimtar të auditimit të KLSH-së... datë 10.03.2026”. Kjo nënkupton se po të mos ishte për kontrollin dhe detyrimin e lënë nga KLSH në mars 2026, strukturat financiare të bashkisë nuk do t’i kishin pasqyruar saktë këto

19

vlera kontabël. Gabime dhe Shkelje Ligjore. Shkelje e Ligjit për Financat e Vetëqeverisjes Vendore: Moskonsolidimi I UK Fier dhe paraqitja e saj me vlerë zero bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” dhe Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të cilët ngarkojnë me përgjegjësi autoritetet ekzekutive të bashkisë për të garantuar kontroll dhe llogaridhënie mbi çdo aset dhe ndërmarrje publike nën varësi. Tejkallim i Afateve Ligjore të Raportimit. Protokollimi i pasqyrave financiare të institucioneve vartëse, që për dijeninë tuaj, se nuk jua thashë në fillim. Bashkia ka në varësi 6 ndërmarrje dhe 3 shoqëri aksionere. Protokollimi i pasqyrave financiare të këtyre institucioneve vartëse deri në mes të muajit prill 2026 (p.sh. Klubi Apollonia më 16 prill, Drejtoria e Artit më 17 prill, shkresat e prillit drejtuar UK Fier) tregon tejkallim të afateve standarde ligjore për mbylljen e llogarive dhe dorëzimin e pasqyrave të këtyre institucioneve vartëse pranë Ministrisë së Financave, duke shkelur udhëzimet për mbylljen e buxhetit. Për materialin e Bilancit, materialin zonja që për hir të së vërtetës, në mbështetje të koleges Yllka Sheshi, me lutjen time, znj. Pranvera ma nisi me e-mail në exel, sepse materiali i hedhur tek grupi ishte i palexueshëm. Për Bilancin, bazuar në analizën e detajuar të Pasqyrës së Flukseve Monetare 2025 dhe krahasimit të saj me pasqyrat e tjera të konsoliduara Pozicioni Financiar dhe Performanca Financiare, bien në sy disa gabime të rënda matematike, mospërputhje logjike, zhvendosje qelizash dhe mungesë të dhënash që cenojnë rëndë integritetin e këtij dokumenti zyrtar. Më poshtë ju jap një analizë të strukturuar të anomalive kryesore, të cilat janë pika kritike në auditimit të këtij bilanci. Gabime të Rënda në Formulën e Totaleve (Horizontalisht dhe Vertikalisht. Gabimi I trashë te rreshti 1 (Shuma Totale e Veprimtarive të Shfrytëzimit): Në kolonën e fundit “Shuma Totale” për rreshtin 1 (VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT), vlera e shënuar është 4,272,918.21 lekë. Mirëpo, nëse mblidhen horizontalisht të gjitha kolonat e këtij rreshti (Aparati + Ndërmarrjet e varësisë), shuma reale duhet të jetë 2,237,997,121.51 lekë (mbi 2.2 miliardë lekë). Ky është një gabim flagrant formule ose vlerë e vendosur manualisht, që nxjerr jashtë funksioni saktësinë e të gjithë kolonës së totaleve. Si ky kemi edhe gabime të tjera plotë por për të mos marrë kohë, nuk po i përmend. Mospërputhje të pashpjegueshme të Likuiditeteve, Gjendjet Fillim viti me Gjendjet Fund Viti që thuhet në termat ekonomikë. Sipas rregullave kontabël, Teprica në Fillim të Vitit (Rreshti 33) +/- Rritja/Rënia Neto (Rreshti 32) duhet të jetë baras me Tepricën në Fund të Vitit (Rreshti 34). Te ndërmarrjet në varësi kjo logjikë thyhet plotësisht. FK Apollonia: Rritja neto e vitit është 4,934,386 lekë dhe gjendja në fillim ishte 35,902 lekë. Gjendja në fund duhet të ishte 4,970,288 lekë, por në tabelë është shënuar 31,169 lekë. Ka një humbje ose mospërputhje të pashpjeguar prej gati 5 milionë lekësh. Klubi Shumësportesh Apollonia SH.A. Rritja neto e shënuar për vitin është 0 lekë. Gjendja në fillim ishte 667,906 lekë. Logjikisht, gjendja në fund duhet të mbetet e njëjtë, por në tabelë është shënuar 2,588,616 lekë. Ka një rritje prej 1,920,710 lekësh të parave në arkë/bankë pa asnjë veprimtari financiare të deklaruar në rreshtat e sipërm. Po ashtu kemi tek Drejtoria e Artit dhe Kulturës, tek Ndërmarrja e Shërbimeve Publike të tilla anomali. Mungesa e Plotë e të Dhënave për Ndërmarrje Kyçe, kampioni është Ujësjellësit e thamë. Kemi një Përfshirje e Transaksioneve Jo-Monetare ose Artifaktet Kontabël. Te rreshti 31 (Levizje e brendshme e transfertat te tjera),

20

Aparati I Bashkisë ka pasur një fluks dalës masiv prej -1,538,930,258.50 lekë (mbi 1.5 miliardë lekë). Duke kontrolluar pasqyrën e Performancës Financiare (llogaria 8423), ky zë përfaqëson “Transferim i ndryshimit të gjendjes së inventarit”. Ndryshimi i vlerës së inventarit në magazina është një veprim kontabël jo-monetar (nuk ka lëvizje fizike parash nga banka). Përfshirja e tij në Fluksin Monetar si “dalje parash” është bërë me qëllim që të “përdoret si xhol” për të balancuar me forcë rritjen neto të mjeteve monetare me gjendjen e llogarisë bankare. Kjo distorcionon krejtësisht qëllimin e Pasqyrës së Flukseve Monetare.

Z.Melsi Bogdani

Niku të lutem konkludo se vajti goxha!

Z.Kreshnik Dapi

Tani të nderuar kolegë, nëse flasim me shifrat zyrtare të vetë dokumentit që na kanë dorëzuar për performancën financiare rezultati neto i periudhës për vitin 2025 na paraqitet në letra si një fitim apo tepricë pozitive prej saktësisht **287,592,413.88 lekësh** por unë ju ftoj të shohim se si është fabrikuar kjo shifër pozitive për të gënjyer këshillin bashkiak, kjo tepricë prej 287 milionë lekësh ekziston sepse në zërin e të ardhurave të veprimtarisë, administrata ka futur si xhol llogarinë **8423** që quhet “**Transferim i ndryshimit të gjendjes së inventarit**” me vlerën marramendëse prej **1,592,967,729.50 lekësh** nëse bëjmë një llogari të thjeshtë matematike dhe zbresim këtë lëvizje fiktive jo monetare prej 1 592 miliard lekësh nga rezultati zyrtar bie menjëherë maska e suksesit dhe Bashkia Fier del automatikisht me një humbje apo deficit real mjaft të thellë prej **1,305,375,315.62 lekësh**. Kjo shifër negative është humbja e vërtetë operationale e aparatit të bashkisë e cila është fshehur nën jorganin e inventarëve të fryrë artificialisht pa llogaritur këtu se sa do të thellohej ky deficit nëse do të shtoheshin edhe borxhet e fshehura të Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike dhe humbjet reale të tyre.

Znj.Evis Sema


Kryetar, sapo folët qëparë për ish Kryetaren, e cila ka folur minutazh më shumë se gjysma e të gjithë të tjerëve. Po tani krahasohet ky minutazh me atë ? Të lutem mbajë një të njëjtin standart ! Mbajë të njëjtin standard !

Z.Melsi Bogdani

Niku ka të drejtë, të lutem konkludo! Endri të lutem ! Të kam tërhequr dy herë vëmendjen të lutem konkludo sepse vajti goxha !

Z.Kreshnik Dapi

Kryetar, të lutem që ta mbyll edhe një herë që ta kuptoni. Ne në muajin dhjetor të çdo viti miratojmë buxhetin e bashkisë, që në gjuhën popullore është kuleta, portofoli i Bashkisë. Ky sot, ta bëjë një çikë gazmore me që ndërhyri Visa, në gjuhën turke quhet hesap, në gjuhën popullore shqiptare quhet llogari e Bashkisë. Jemi mbledhur këtu të bëjmë llogarinë e Bashkisë. Përgjegjësi ligjore ka direkt Komisioni i Ekonomisë, dhe unë prandaj, dhe këtë e them me shumë keqardhje dhe kërkoj falje nqs përcjell ndonjë emocion negativ, se nuk dua të bëhem në rolin e Kryetarit të

 21

Bashkisë dhe atyre dy kolegëve tek mbledhja e kaluar, që për një zyrë 20 metra katrorë, lanë namë këtu, që ja lejon ligji...

Z.Melsi Bogdani

Niku të lutem konkludo, se po mbajmë Drejtoreshën këtu !

Z.Kreshnik Dapi

Kini një përgjegjësi të madhe, vitin tjetër mund të mos jenë shumë nga ne këtu në Këshill dhe mund të thirremi në të tjera vende. Nëse miratojmë një bilanc të tillë me shkelje kaq të rënda, kemi direkt përgjegjësi penale, dhe morale para qytetarëve.

Znj.Erlinda Llupi

Për ty por jo për ne.

Z.Agron Profka

Kryetar fole më parë për presion, tani po na bëhet prapë presion.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderi ! Drejtoreshë të lutem dy gjëra shkurtimisht !

Znj.Pranvera Cina

Së pari, nuk bie dakord me gjithçka u tha, për arsye sepse ky bilanc është i përgatitur bazuar tërësisht në bazë ligjore, në udhëzimet e përpiluara dhe miratuara me Ministri të Financave dhe bilancet janë pasqyra financiare që rakordohen me degën e thesarit, që paraqiten për monitorim Ministrisë së Financave dhe nuk janë vlera të paraqitura...

Z.Kreshnik Dapi

Të bëjë një pyetje ? Enver Kalemi , kush është ?

Znj.Pranvera Cina

Urdhëro ?

Z.Kreshnik Dapi

Enver Kalemi.

Znj.Pranvera Cina

Urdhëro ?

Z.Kreshnik Dapi

Kush është Enver Kalemi ? Mbase s'e di ?

Znj.Evis Sema

Po ç'lidhje ka kjo ?

Znj.Pranvera Cina

Jo, me ato që kuptova, një sekond, me ato që kuptova nga relatimi juaj, do një analizë nga një financier.

Z.Kreshnik Dapi

Kush është ? Është autori i pasqyrës financiare që ti na ke nisur po ti se dije fare.

Znj.Pranvera Cina

I formatit.

Z.Kreshnik Dapi

I formatit pra.

Znj.Pranvera Cina

I formatit. Shumë mirë dhe duhet ta kishit kuptuar që ky format është i miratuar nga Ministria e Financave, i publikuar dhe...

Z.Kreshnik Dapi

Dhe i mbushur copy-paste.

Znj.Pranvera Cina

Jo, e keni gabim. Dhe kontabilizimi i llogarive ekonomike bëhet mbi një bazë ligjore që askush nuk mund të devijojë dhe askush nuk mund të paraqesë si...Nuk mund të paraqesë si vlera...

Z.Endri Jaupaj

Kryetar kam unë një diçka si Kryetar grupi të lutem.

Z.Melsi Bogdani

Po, shkurtimisht Endri, se do kalojmë në votim.

Z.Endri Jaupaj



23



Atëherë, shkurtimisht. Një sekond vetëm...

Z.Agron Profka

Endri Kryetar i kujt grupi je të lutem shumë ?

Znj.Evis Sema

Në emër të kujt grupi, kërkojmë sqarim, në emër të kujt grupi ?

Z.Endri Jaupaj

Grupi i Pavarur

Znj.Evis Sema

Në emër të kujt grupi ?

Z.Endri Jaupaj

Atë pyetje ma drejton Kryetari.

Z.Melsi Bogdani

Atëherë meqenëse, jo të lutem, të lutem, se më është ngritur shumë herë kjo, të lutem. Ti jap një përgjigje kësaj pyetje që të heqës edhe këtë pjesën e... Atëherë...Pozicioni, ligjshmëria dhe subjekti politik që përfaqëson Endri Jaupaj, në Kryesinë e Këshillit Bashkiak është i përcaktuar që prej konstituimit të këtij Këshilli. Bazuar në rezultatet zyrtare të çertifikuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe zgjedhjet vendore të 14 muajit Majit, ku zoti Jaupaj përfaqëson grupin politik prej 4 këshilltarësh të mandatuar në logon e Partisë Demokratike të Shqipërisë, duke përmbushur në këtë mënyrë të gjitha kriteret e parashikuara nga rregullorja e funksionimit të Këshillit Bashkiak në përfaqësim, në kryesi edhe në Këshillin Bashkiak.

Znj.Evis Sema

Jo, jo, jo, nuk jemi këtu kryetar, se gjatë rrugës ka pasur pengesa. Nuk jemi grup fëmijësh, dhe më vjen keq që po shpreheni. Sepse nëse ashtu edhe Kryetarja e Këshillit ishte zgjedhur dhe mandatuar që të ishte Kryetare e Këshillit, por ja që dha dorëheqjen. Jo se na the që është mandatuar. Nqs ka 4 veta në grup, atëherë ka i përfaqësues në Kryesi. E ka grupin me 4 veta Endri, që të jetë përfaqësues në Kryesi ? Mqs e hape.

Z.Melsi Bogdani

Të lutem, të lutem. Një sekond, një sekond se kam më ky sqarimi. Që të marrë fund kjo pjesë, të marrë fund kjo dilemë, të lutem. Atëherë, e nderuar këshilltare... Unë si kryetar, unë si kryetar i Këshillit, të lutem! Unë si kryetar i Këshillit...



24



Z.Endri Jaupaj

Evis Sema, merr një kopje të procesverbalit se ta ka thënë që ditën e parë këtë...

Z.Melsi Bogdani

Të lutem, të lutem! Të lutem, kolege! Unë jam zgjedhur kryetar i Këshillit Bashkiak, të lutem, kolege! Unë jam zgjedhur kryetar i Këshillit Bashkiak më 30.04.2026. Nga momenti i zgjedhjes sime deri në këtë moment që po flas përpara jush, nuk ka asnjë lëvizje politike, nuk ka asnjë kërkesë me gojë apo me shkrim për të lëvizur ndonjë këshilltar.

Znj.Evis Sema

Nuk thashë këtë, nuk kërkova këtë gjë. Unë kërkova pse...

Z.Melsi Bogdani

Të lutem vazhdojmë me pikën e radhës të Rendit të Ditës.

Z.Endri Jaupaj

Atëherë, kontrolli i Lartë i Shtetit ju ka lënë disa pika që i ka gjetur dhe po i bie shumë shkurt, parregullsi në pasqyrën financiare. Po thotë Kontrolli i Lartë i Shtetit, nuk po them unë si anëtar i Këshillit Bashkiak. Diferenca në aktive dhe detyrime që nuk kanë qenë domethënë të sakta. Problematikë në investime, në inventarizim, magazinim...

Znj.Evis Sema

Kanë të bëjnë këto me pikën e Rendit të Ditës, me këto pasqyrat financiare ?

Z.Melsi Bogdani

Të dëgjojë pyetjen Drejtoresha, le të përgjigjet Drejtoresha të lutem !

Z.Endri Jaupaj

Unë nuk po pyes Evis Semën tani, nuk ka kuptim kjo.

Znj.Evis Sema

Unë bëra vërejtjen pararendësit, tani doli Endri. A është brenda pasqyrave financiare kjo, brenda pikave të Rendit të Ditës ?

Z.Melsi Bogdani

Endri konkludo në pikën për Drejtoreshën.

Z.Endri Jaupaj

   25





Gjetjet që ka lënë KLSH-ja, që sipër citova, Do t'i citoj edhe një herë ?

Znj.Pranvera Cina

Jo nuk ka nevojë.

Z.Endri Jaupaj

Ok. Më thuaj çfarë masash keni marrë për këto gjetje që ka lënë KLSH- ja ?

Znj.Pranvera Cina

Të gjitha rekomandimet e lëna nga grupi i KLSH-së janë zbatuar në pasqyrat financiare dhe janë të gjitha...

Z.Endri Jaupaj

Mangësi në të ardhura dhe shpenzime thotë, si e kupton ti këtë ?

Znj.Pranvera Cina

Po pra ndaj ju ndoshta nuk I bëni një interpretim të duhur nga ana financiare. Ka të bëjë me kontabilizimin e llogarive midis tyre. Midis Aktiveve dhe Pasiveve, midis Të Ardhurave dhe Shpenzimeve.

Z.Endri Jaupaj

Problematikë thotë në inventarizim, se problematika në inventarizim dmth që juve ju mungojnë, ata si gjejnë.

Znj.Pranvera Cina

Jo, jo, jo e ke gabim.

Z.Endri Jaupaj

Si, si do të thotë ?

Znj.Pranvera Cina


Jo,jo,jo e ke gabim. Kontabilizimi I llogarive, e theksojë vazhdimisht këtë.

Z.Endri Jaupaj

Diferenca thotë në Aktivët dhe Detyrimet, si thotë ?

Znj.Pranvera Cina

Kontabilizimi I llogarive midis llogarive të aktiveve dhe pasiveve...



26

Z.Endri Jaupaj

Keni marrë masa për këto gjetjet ?

Znj.Pranvera Cina

Po pra janë zbatuar të gjitha tek pasqyrat.

Z.Endri Jaupaj

Ti se the.

Z.Kreshnik Dapi

Pse nuk ja vini në dispozicion Këshillit raporti e kontrollit ?

Znj.Pranvera Cina

Ajo është diçka tjetër. Në lidhje me pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2025, janë paraqitur të gjitha rekomandimet dhe janë bërë sistemimet.

Z.Endri Jaupaj

Epo atë duhet të thoshe të parën

Znj.Pranvera Cina

Dhe për sa i përket vlerës që nuk është shprehur, është vendosur gabimisht, por është sistemim veprimi, të cilën ligji financiar e lejon këtë gjë. Që në rast se një vlerë është kontabilizuar gabimisht në një llogari, është bërë sistemim veprimi dhe është çuar në llogarinë e duhur sipas udhëzimit të pasqyrave financiare. Doja të sqaroja dhe diçka në lidhje me pasqyrat financiare...

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit Drejtoreshë! E hedhim ne votë projektvendimin për miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara për vitin 2025 të Bashkisë Fier dhe institucioneve vartëse.

Z.Endri Jaupaj

Do bëhet objekt i SPAK-ut?

Znj.Pranvera Cina

Këtë , absolutisht !

Z.Melsi Bogdani

Kush është dakort ?

Znj.Mirela Pitushi

Vendosen vlerat financiare kur mblidhen në Buxhet.

Z.Kreshnik Dapi

O Mirela na fal të lutem se jemi në votim.

Z.Melsi Bogdani

Numëroji pak të lutem !

Z.Endri Jaupaj

Jam anëtar i Këshillit Bashkiak në betim unë Mirelë, dhe kur je në betim e di ti se ke qenë më lart se mua.

Z.Kreshnik Dapi

Nuk kalon

Z.Armando Çupa

Janë 5 kundër, një abstenim.

Z.Melsi Bogdani

Edhe një herë të lutem !

Z.Armando Çupa

Janë 5 kundra dhe një abstenim.

Z.Melsi Bogdani

Ngrini kartonat ju lutem !

Z.Endri Jaupaj

5 kundra 1 abstenim. Janë 30, është e bërë llogaria, 24.

Z.Armando Çupa

Mbajini ngitur ti numërojë Kryetari!

Z.Endri Jaupaj

Po.

28

Z.Melsi Bogdani

3, 5, 8, 11, 13, 16, 19, 21,22, 23, 25. Janë 25 vota pro.Sa ishin kundër ?

Z.Arnando Çupa

5 kundra dhe 1 abstenim.

Z.Endri Jaupaj

5 kundër 1 abstenim.

Znj.Fatbardha Merkaç

Mels sa do kjo?

Z.Melsi Bogdani

25+1.

Znj.Fatbardha Merkaç

E po.

Z.Kreshnik Dapi

Deklaroje Kryetar, kalon apo jo?

Z.Melsi Bogdani

Ja një sekondë se po shkruaj e di unë atë pjesë. Atëherë pika 6 projektvendim për miratimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2025 të Bashkisë Fier dhe institucioneve vartëse nuk kalon. 25 vota pro, 5 kundër, 1 abstenim, nuk miratohet. Shumë faleminderit !

Pro 25 vota

Kundra 5 vota

Abstenim 1 votë

Nuk miratohet.

Pika e shtatë e Rendit të Ditës.

Projektvendim:” Për miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2025 të Shoqërisë Apolonia Sh.A”.

Z.Melsi Bogdani



Kush është, Drejtor ?

Znj.Pranvera Cina

Të bëjë një raportim financiar dhe më pas, në qoftë se do ketë pyetje, kemi edhe administratorin e klubit Shumësportësh këtu. Të ardhurat për vitin 2025 për klubin e Shumësportësh Apolonia Sh.A. janë në vlerën totale 47,536,772 lekë, nga të cilat të ardhura nga aktiviteti 455,360 lekë, financim nga Bashkia 45 milionë lekë, rimarrje subvencionesh në vlerën 2,081,412 lekë. Shpenzimet për vitin 2025 janë në vlerën 50,185,676 lekë."

Z.Endri Jaupaj

Pranverë të shtojë diçka unë. Kur flet tek shifrat, të lutem se ngatërrohen të vjettrat me të rejtat. E thua dot edhe në Euro pak a shumë ?

Znj.Pranvera Cina

Jo, flasim gjithmonë financat, flet në Lekë.

Z.Endri Jaupaj

Hë se do ta them unë, sa të mbarosh ti do ta them unë.

Znj.Mirela Pitushi

Është mijë lekë.

Z.Endri Jaupaj

Po pra po.

Znj.Pranvera Cina

Në pasqyrat financiare flasim në lekë.

Z.Endri Jaupaj

Po do flasim në lekë do ti them unë në euro që të jenë më të qartë ata që na dëgjojnë, se ngatërrohen.

Znj.Mirela Pitushi

Jo ore pse. Ekonomisti flet në lekë.

Z.Agron Profka

Ti ponon në euro.

Z.Endri Jaupaj

Po punoj, me çfarë të duash ti punojë, edhe me dollarë punojë.

Z.Melsi Bogdani

Vazhdo Drejtoreshë.

Znj.Pranvera Cina

Atëherë, detajimi i shpenzimeve për klubin e Shumësportësh për vitin 2025 është si më poshtë: paga për punonjës, sigurime shoqërore, pagesa të anëtarëve të Këshillit Administrativ dhe ekspertëve kontabël, shpenzime për trajnerët dhe sportistët, si edhe materiale zyre, federim, energji elektrike, ujë, qera dhe mirëmbajtje ambientale sportive, transport dhe hoteleri, shpenzime të tjera siç janë komisione bankare, internet, siguracione jete për sportistët. Gjithashtu kemi dhe amortizimin e aktiveve afatgjata materiale në vlerën 7,424,096 lekë. Amortizimi është një ndër arsyt kryesore që ndikon në rezultatin neto të këtij klubi, që është me vlerën 2,648,904 lekë. Duke e krahasuar me një vit më parë, shikojmë që kemi një përmirësim të situatës financiare të klubit. Faleminderit !

Z.Endri Jaupaj

Unë kam vetëm një fjalë, shpenzimet...

Z.Melsi Bogdani

Të lutem Endri, Komisioni.

Znj.Brunilda Hoxhaj

Të flasi çikë Komisioni.

Z.Endri Jaupaj

Po Komisioni po patjetër.

Znj.Erlinda Llupi

Komisioni u mblodh 2 vota pro 2 kundër. Kemi nxjerrë një problematikë dhe do të dëshironim disa përgjigje. Atëherë, klubi mbështetet pothuajse totalisht nga fondet e Bashkisë Fier dhe ka shumë pak të ardhura të pavarura nga burime të tjera. Shpenzimet për pagat, sigurimet, personel të jashtëm janë shumë të larta krahasuar me të ardhurat. Në këtë zë janë shpenzuar rreth 16.3 milion lekë, duke përbërë një nga kostot më problematike. Klubi funksionon më shumë si strukturë, sesa si organizatë sportive me të ardhurat e veta. Pasuritë dhe infrastruktura në dispozicion nuk po përdoren për të gjeneruar të ardhura. Pse klubi vazhdon të dalë me humbje dhe pse financohet kryesisht nga Bashkia Fier ? A ekziston një analizë konkrete mbi kostot që po

31

rëndojnë më shumë buxhetin ? Çfarë masash janë planifikuar për uljen e shpenzimeve jo efektive ? Pse të ardhurat vetjake të klubit janë kaq të ulëta dhe çfarë strategjie ka për rritjen e tyre ? A kanë ndonjë plan për sponsor privat, marketing, akademi sportive ose përdorim ekonomik të aseteve të klubit ? Si justifikohen shpenzimet shumë të larta për punonjësit e jashtëm dhe a është bërë auditimi i tyre ? Kush përfiton nga këto pagesa dhe çfarë performancë sjellin ato në klub ? A ka mundësi për sigurimin ose optimizimin e këtyre kostove për të stabilizuar financat ?

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit !

Z.Paljon Zarka

Përshëndetje të gjithëve ! Dëgjova...

Z.Armando Çupa

Paljon, të lutem mikrofonin.

Z.Paljon Zarka

Po. Flasim, të dëgjova, u kapa tek diçka aty, kur flasim për shpenzimet e larta të jashtme, çfarë do të thuash me këtë, të lutem se s... ?

Znj.Erlinda Llupi

Personel të jashtëm.

Z.Paljon Zarka

Znj.Erlinda Llupi

Personel i jashtëm, çfarë do të thotë ?

Z.Paljon Zarka

Personeli i jashtëm... Personeli i jashtëm do të thotë trajnerë, sportistë. Të gjithë trajnerët dhe sportistët kanë kontrata shërbimi me klubin Apolonia. Dhe ne e kemi etiketuar si sportist të, si punonjës të dmth , si punonjës të jashtëm. Sepse klubi e ka të pamundur që të lidhi kontrata afatgjata, sepse nuk ka garancinë ekonomike që të gjithë sportistët që lidh kontratë t'i mbajë për gjatë gjithë viteve. Ndërsa punonjësit që janë ose struktura e klubit, përbëhet prej rreth 28 vetash, ku pjesë e strukturës janë edhe punonjësit e mirëmbajtjes së stadiumit."

Znj.Erlinda Llupi

Dakord, po sepse kanë një kosto kaq të lartë ndërkohë që të ardhurat janë të ulëta pse të duhen ?

32

Z.Paljon Zarka

Po, të ardhurat janë të ulëta sepse ne sot nuk mund t'i gjenerojmë dot të ardhura, jo vetëm ne, po të gjitha klubet në Shqipëri e kanë të pamundur të gjenerojnë të ardhura. Unë e kuptoj që shumë nga ju pa dashur t'i fyej njeri e ka të, të pakconceptuar që të kuptojë se çfarë vështirësie është sporti sot. Sporti sot nuk kemi një ligj sponsorizimi që ne ta afrohem për sponsorët ose bizneset sot, sepse biznesi nuk ka asnjë lloj ë... interesi të vijë. Sot, në qoftë se ne, ato pak të ardhura që i kemi akumuluar i kemi akumuluar nga akademia jonë, nga sportistët tanë të vegjël që, që vinë edhe janë pjesë e e klubeve. Kështu që...

Z.Erlinda Llupi

Ju keni ndonjë plan me sponsor privat ?

Z.Endri Jaupaj

Ne nuk themi... ?

Z.Melsi Bogdani

Të lutem të mbarojë Kryetarja e Komisionit !

Z.Endri Jaupaj

Po pse ta bëjmë bisedë, ta bëjmë bashkëbisedim ?

Z.Melsi Bogdani

Jo, jo kur të mbarojë pyetjet, të mbarojë pyetjet Kryetarja e Komisionit.

Z.Endri Jaupaj

Drejtori I Sportit mbas 3 vitesh ka dalë këtu përpara Këshillit...

Z.Melsi Bogdani

Endri të mbarojë pyetjet Kryetarja e Komisionit dhe fillo.


Z.Endri Jaupaj

Ok, Ok.

Znj.Erlinda Llupi

A keni plan për sponsor privat ?

Z.Paljon Zarka



Sapo e thashë pak më parë që ne jemi munduar me shumë sakrifica. Jo vetëm unë, por të gjithë stafi që unë kam atje, dhe trajnerët vetë, por edhe prindërit vetë janë munduar që të ofrojnë të ardhura nga sponsorët, dhe me gjithë sakrificat dhe mundin që kemi bërë kemi mundur të afrojmë disa. Po kjo nuk është se do të mbulojë të gjitha shpenzimet e klubit pavarësisht, sepse janë federimet, janë... Ne sot aktualisht nuk kemi vetëm një ekip sportiv, kemi 8 disiplina sportive. Kemi boksen, çiklizmin, basketbollin, volejbollin, shahun, mundjen, peshëngritjen, pingpongut, kështu që nqs juve ju duket një shumë e mjaftueshme ajo që që ne ezaurojmë për sportin, nuk e di pastaj.

Znj.Erlinda Llupi

Pse nuk afrohen investitorët, pse nuk kanë interes ?

Z.Paljon Zarka

Urdhëro

Znj.Erlinda Llupi

Pse nuk afrohen investitorët, pse nuk kanë interes ?

Z.Paljon Zarka

Është hera e tretë që po e përsëris dhe më duket se...Është shumë e vështirë për të gjeneruar sot...

Znj.Erlinda Llupi

Pse nuk kanë ? Ndoshta nuk kanë interes për të bërë diçka për fëmijët e tyre ?

Z.Paljon Zarka

Jo mo jo, sepse nuk një ligj sponsorizimi. Një biznes nqs vjen të sponsorizojë, do dhe një mbështetje nga klubi, do dhe një lehtësim që të vijë ta ta sponsorizojë atë sport.




Znj.Erlinda Llupi

Atëherë duke vazhduar kështu ke menduar se ku do jeni pas 3 ose 5 vitesh ?

Z.Paljon Zarka

Unë sapo e thashë pak më parë që ne jemi munduar me gjithë ndihmën... dhe promotori dhe ndihma më e madhe e jona është Bashkia Fier, jemi munduar që ta mbajmë gjallë sportin. Ju para pak, një mbledhje më parë, ngritet kauzën për për FK Apoloninë që është një kategori më poshtë, edhe si Bashkia apo Këshilli e ka lënë këtë gjë të shkojë drejt kësaj pike ? Tani jemi në një...

Znj.Brunilda Hoxhaj



34



Edhe ai është shqetësim, është shumë shqetësim I madh, është shumë shqetësim I madh.

Z.Paljon Zarka

Po pra. Unë ju bëjë thirrje të gjithë këshilltarëve, të paktën 2-3 veta nga ju kam parë që janë edhe dashamirës sporti, që kanë ardhur të shikojnë ndeshje basketblli. Është nënkryetari që ka ardhur, është nënkryetari tjetër që ka qenë sportist në sportin e volejbollit, kemi Profkën që po ashtu sportist. Mua më vjen mirë që më së fundmi, ju keni interes për sportin dhe doni ta ndihmoni sportin.

Znj.Brunilda Hoxhaj

Ta ndihmojmë dhe ta zhvillojmë në qytetin tonë. Fieri është një nga qytetet më të zhvilluara në Shqipëri, e ka traditë sportin.

Z.Paljon Zarka

Po pra, patjetër.

Z.Melsi Bogdani

Një sqarim nga nënkryetari, po.

Z.Nustret Avdullaj

Mbase ju duket e pavend, por si ish sportist, meqenëse më përmendi. Do ju ftoj të nderuar këshilltarë...

Z.Melsi Bogdani

Mikrofonin Nustret, se s' dëgjohesh në sallë.

Z.Nustret Avdullaj

Dakord. Sporti dhe Kinoteatri, Pallati I Sportit dhe Kinoteatri, nuk janë mjete për të përfituar, thjesht ne duhet të mendojmë shumë për masivizimin. Thjesht në qoftë se do isha dakord me vërejtjen tuaj për të punuar më shumë për masivizimi, sesa për të përfituar. Siç e tha edhe parafolësi, nuk ka një ligj për sportin të dedikuar dhe të specifikuar, që të vijnë sponsora të ndryshëm për të investuar në sport. Ky është një...përgjegjësi e madhe, nga të gjithë, nga stafi por edhe nga ne, të përpiqemi për masivizimin. Ky duhet të jetë qëllimi dhe jo të përfitojmë. Pastaj për buxhetin konkretisht, për vlerat sspecifike, nuk jam I profilit për ti specifikuar, por duhet të kuptojmë...kjo ndërhyrja ime ishte për të kuptuar që...sporti dhe arti jemi në pika kritike që duhet të përpiqemi për masivizimin. Ky duhet të jetë qëllimi ynë. Faleminderit !

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit ! Yllka

Z.Paljon Zarka

35

Unë do thosha, mund të them unë diçka...

Z.Melsi Bogdani

Ja një sekondë, Yllka Paljon pastaj, po.

Znj.Yllka Sheshi

Duke qenë se jam pjesë e sportit, por duke qenë se jam pjesë e një shkolle, ku ekipi i Apolonisë së Fierit volejball bën stërvitje, më vjen keq që Apolonia e futbollit futbollit...investojmë shuma marramendëse, dhe jemi në gjendje ku jemi, dhe të mos investohet mbi basketbollin, volejbollin, që vërtetë ne kemi një përfaqësim dinjitoz...të trajnerëve në të gjithë kategoritë e tyre, dhe kuptohet për sportin sidomos dhe për artin, sportisti jep, ndërsa biznesi nuk investon. Prandaj mendoj që ata bëjnë punën më të mirë të mundshme. Që duhet një suport sepse vërtet, shoqëritë private nuk...shoqëritë private nuk investojnë tek sporti për aq sa ata japin në sport. Unë di të them që ekipi i Apolonisë në basketboll, volejball, që jam më shumë brenda, japin dhe na kanë bërë krenar për atë që kanë bërë.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit ! Bruna pastaj Niku.

Znj.Brunilda Hoxhaj

Doja ti thosha edhe një çikë zotit nënkryetar për atë që tha që nuk përfitojmë gjë nga teatri. Nuk mendoj se është ashtu. Nga teatri mund të përfitojmë shumë siç kemi përfituar. Në kohët tona, kur është dhënë, kur janë dhënë aq shumë shfaqje, që vriteshin njerëzit të vinin të hynin në atë sallë, ka pasur përfitime të jashtëzakonshme. Po sot ne e kemi katandisur atë teatër, për faqe të zezë. Prandaj i propozoj Kryetarit të Këshillit, në një mbledhje të ardhshme, të jetë Drejtoresha e Artit dhe Kulturës e ftuar këtu në këtë sallë siç është zotëria sot për sportin dhe të na thuhet për buxhetin çfarë është...sa e kanë pasur buxhetin dhe të gjithë harxhet e tyre për këtë 6 mujor sa jemi, edhe të shikojmë se ku janë rezultatet, se gjendja është...për faqe të zezë.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit ! Niku, pastaj Agroni, shumë faleminderit Bruna !

Z.Kreshnik Dapi

Tani Kryetar, në lidhje me pikën në fjalë unë kam përgatitur një fjalë edhe për këtë pikë. Në radhë të parë duhet ti drejtohem Paljont, një sekondë...ose Administratorit

Znj.Evis Sema

Vetëm përcakto minutazhin Kryetar.

Z.Paljon Zarka

S'ka problem.

Z.Kreshnik Dapi



36



Ju kërkojë ndjesë. Në një farë mënyre unë e mirëkuptojë atë djalë, ai është në një pozitë shumë të vështirë atje, sepse nuk varet nga ai personalisht. Në këshillën time si mik, po të shkonte në një ndërmarrje tjetër apo në ndonjë institucion tjetër, ai do të shkëlqente dhe ne të tërë këtu, nuk e kemi konkretisht me personin, Paljonin, apo me persona të tjerë të Këshillit Administrativ të asaj shoqërie. Problemi është që Këshilli Bashkiak ka një detyrim ligjor dhe kushtetues për të garantuar transparencën maksimale dhe mirë menaxhimin e çdo qindarke, të taksapaguesve të qytetit tonë. Dhe kur i bëjmë një analizë me përgjegjësi relacionit dhe pasqyrave financiare të kësaj shoqërie, konstatojmë gjetje serioze që duam ne apo nuk duam, si qytetar, si shokë, si miq, na pengojnë ta miratojmë këtë bilanc në këtë seancë ose në këtë gjendje në çdo seancë tjetër. Së pari në dokumentin zyrtar është një opinion me rezervë...

Znj.Evis Sema

Nuk do ta miratojë ai, e ke të qartë këtë gjë. Përcaktoni minutazhin Kryetar, përcaktoni minutazhin.

Z.Kreshnik Dapi

O ti të lutem më lërë tani...

Z.Melsi Bogdani

Niku o Niku, sepse disa nga pikat... Visa mos ndërhy, ndërhyjë unë Visa.

Z.Kreshnik Dapi

Unë po flasë ajo ndërhyjë, kush është ajo ?

Z.Melsi Bogdani

Disa nga pikat e trajtimit financiar të shumë klubit i kishe edhe në relacionin e përgatitur pak më parë.

Z.Kreshnik Dapi

Edhe një herë më lërë të mbarojë fjalën se ...

Z.Melsi Bogdani

Po pra, ngaqë kaloi kohë shumë e gjatë, edhe në relacionin e mëparshëm edhe tani

Z.Kreshnik Dapi

Le të kalojë.... Atëherë ne i bie që mos të flasim, të rrimë.

Z.Melsi Bogdani

Jo, do flasësh brenda limit kohor që është përcaktuar në rregullore.

Z.Kreshnik Dapi

Më lërë të mbarojë. 5 fjali ka të tëra...

Z.Melsi Bogdani

Po.

Z.Kreshnik Dapi

Më lërë të mbarojë se re edhe ti në grackën e...

Z.Melsi Bogdani

Jo nuk bie në grackë unë të askujt, vetëm në grackë nuk bie unë, fjalën grackë në raport me mua do ta heqësh.

Z.Kreshnik Dapi

Më lërë ta mbaroj.

Z.Melsi Bogdani

Fjalën grackë tërhiqe në raport me mua. Vetëm unë nuk bie në grackë. Prandaj vazhdo, konkludo në kohën që lejon rregullorja, përcaktimi I rregullores.

Z.Kreshnik Dapi

Të vazhdojë se do kisha mbaruar.

Z.Mesi Bogdani

Po.

Z.Kreshnik Dapi

Dokumenti zyrtar mban një opinion me rezervë nga ekspertët e pavarur kontabël, janë ajo zonja që s'ja kujtojë emrin dhe Alboreni, të cilët ngrenë zyrtarisht alarmin mbi parimin e vijimësisë së kësaj shoqërie duke nënvizuar se ajo rezulton me një humbje sistematike dhe ka shfaqur paaftësi për të gjeneruar të ardhura duke e çuar humbjen e mbartur ndër vite në shifrën prej 351 milionë lekë të vjetra ose 35 milion...

Z.Paljon Zarka

Jo, jo e ke gabim shumë.

Z.Kreshnik Dapi

E ke aty në bilanc.

Z.Paljon Zarka

E ke gabim. Humbja ...

Z.Kreshnik Dapi

Së dyti, më fal ta mbarojë, ne vërejmë një varësi totale dhe të pashëndetshme nga buxheti i Bashkisë Fier pasi nga rreth 47.5 milionë lekë të reja të ardhura totale për vitin 2025 plot 45

38

milione lek janë subvencione të drejtpërdrejta nga paratë e qytetarëve ndërsa të ardhurat nga vetë aktiviteti i klubit janë në një vlerë qesharake, të papranueshme prej vetëm 425 mijë lekësh. Së treti struktura e shpenzimeve mbetet krejtësisht e paqartë veçanërisht zëri për punonjës të jashtëm që kap vlerën e 16.3 milionë lekëve për të cilin ky Këshill nuk mund të votojë pa pasur listën e kontratave dhe justifikimin ekonomik. Ajo që e bën këtë situatë edhe më kritike dhe që legjitimon plotësisht opinionin me rezervë të audituesve është, po themi edhe një gjete e rastësishme që unë duke e përgatitur këtë material sot e gjeta në një Vendim të Këshillit Bashkiak të miratuar nga ky Këshill me numër 90 të datës 25 shtator 2025. Përmes këtij vendimi ekzekutivi u detyrua të kërkonte një ndërhyrje emergjente duke shkurtuar 6 milionë lekë nga shpenzimet operative të vetë aparatit të Bashkisë për t'ia transferuar klubit.

Z.Melsi Bogdani

Ke pyetje për... për, Niku të lutem konkudo në pyetje ose diçka që ke për Administratorin.

Z.Kreshnik Dapi

Pyetjet janë pyetje që bëri Erlinda, sepse e kam trajtuar dhe vjet këtë. Vjet ishte me minus 47 milionë, sivjet është me minus 26 milionë. Tani...

Z.Melsi Bogdani

Po pra, të gjithë materialet dhe të gjitha ato konkluzionet i kanë të gjithë këshilltarët.

Z.Kreshnik Dapi

Humbja është 350 milionë lekë të vjetra. Duhet të japin përgjegjësi ligjore për këtë. Sot po na kërkohet të ngremë dorën.

Z.Melsi Bogdani

Niku siç i keni ju pasqyrat përpara, çdo këshilltar I ka pasqyrat përpara. Dhe... ke pyetje për administratori, jemi në kuadrin e pyetjeve për të marrë përgjigje, në lidhje me çfarë thatë. Ke pyetje, konkludo të lutem...

Z.Kreshnik Dapi

Pyetja është si do të dali ky klub nga kjo situatë dhe sa do të vazhdojmë akoma të japim para nga taksapaguesit ?

Z.Melsi Bogdani

Kaq. Po

Z.Paljon Zarka

Ok. Siç e thashë edhe pak më parë, që të gjithë për punonjësit e jashtëm janë kryesisht, jo kryesisht po 100% janë sportistë dhe trajnerët...që ishte ajo shifra atje. Ndërsa për humbjen, humbja, edhe në qoftë se Këshilli do të marrë vendim për miratimin e kësaj apo nuk do ta marri,

humbja e këtij viti i shtohet humbjes që nga fillimi i këtij, i krijimit të klubit, që shkon në total prej 6 milion...7 milionë e disa lekë të tjera, domethënë, që nuk është 350 milionë.

Z.Kreshnik Dapi

Si sa shkon ?

Z.Paljon Zarka

7 milionë lekë të reja.

Z.Kreshnik Dapi

Po 47 ishin vjet, 26 sivjet ?

Z.Paljon Zarka

Shiko... Shiko edhe një herë, po... Shiko edhe një herë se e ke gabim shifrën, e ke aty.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit. Agron.

Z.Paljon Zarka

Ndërsa, të them, të them, një gjë vërtetë, nuk e di, mbase se kuptoj...Vërtet duhet të vini të shikoni nga afër...sakrificat që i bëjnë të gjithë trajnerët. Jo unë, sepse unë jam, unë jam...

Z.Kreshnik Dapi

Unë nuk e vura gishtin tek ty, ne flasim ligjërisht, ne s'kemi gjë, je shumë I nderuar. Është problem kjo pjesë...

Z.Melsi Bogdani

Gone ta dëgjojmë çikë të lutem! Po Gone.

Z.Paljon Zarka

Po të kisha mbaruar.

Z.Melsi Bogdani

Hë më thuaj, thashë se mbarove.

Z.Paljon Zarka

Ju ftoj të gjithëve që të vini, që të shikoni ato ndeshjet, gjithë sakrificat që bëjnë ata trajnerët, se u përmendën shifra të frikshme, ku dhe kush na dëgjon mendon se këtu ne po bëjmë namin me këto shifra. Por, mos ta harroni, i keni të gjithë, bordoret. Një trajner moshë, paguhet 30-35 mijë lekë të vjetra, ose një zëvendës-trajner, që janë shifra që është qesharake. Kështu që mos mendoni që se, se...

Znj.Pranvera Cina

Çdo gjë është transparente.

Z.Paljon Zarka

Çdo gjë është transparente, mund të vini, në qoftë se doni të vini, të vini në grup, unë jam shumë i hapur të vini, ta kontrolloni, të shikoni, sepse dëgjoj gjëra që... që të vesh në dyshim, thashë, ata trajnerët që punojnë aty, të gjithë, duke filluar që ne kemi në peshëngritje, kemi nënkampionë Europe, trajnerë nënkampionë Europe, apo tek boksi, që morëm titullin nënkampionë, apo tek volejbolli, që kemi qenë në top katër më të mirat në Shqipëri, apo tek basketbolli, që jemi në top katër më të mirat, jemi munduar me thonjë, me thonjë, jo unë, sepse unë bëj detyrën time si drejtues i institucionit, por të gjithë trajnerët dhe të gjithë ata, edhe ata prindërit, që bëjnë sakrifica. Dhe mos ta harroni që, që...ato, kalçetot që lozin fëmijët, apo bëjnë stërvitje, janë të amortizuara dhe nuk bëhet stërvitje dhe ne sot s'kemi ambiente, dhe kushte për të bërë stërvitje me me moshat duke e ditur që të gjithë të rinjtë po na ikin drejt Tiranës dhe po e lënë sportin. Kështu që do ju ftoja të gjithë kush ka paqartësi, sinqerisht e them këtë, ja bëjë thirrje të gjithëve, kush ka paqartësi dhe ka nevojë të jetë I kthjellët, të dijë të gjitha shpenzimet, e ftojë të vijë bashkërisht, të shikojë të gjithë listë pagesat dhe të gjithë prezencat që kemi ne atje.

Z.Kreshnik Dapi

Kemi bilancin o Paljon, kemi bilancin.

Z.Paljon Zarka


Niku ta thashë që sot për një klub sportiv, jo vetëm Apollonia, mos harrojmë që buxhetin Flamurtari apo ekipet e tjera si Teuta e Durrësit e kanë nga 800 milionë, 1,5 milionë apo 2 milionë euro, pa pasur edhe mirëmbajtjen e stadiumit duke pasur parasysh se atje kemi 5 punonjës që mirëmbajnë stadiumin, atë stadium që na ka ngelur e që po mundohemi me mish e me thua ta mbajmë edhe atë, që të paktën Fierit ti ngali një fushë, është e pamundur që një klub në Shqipëri, flasë, jo vetëm këtu në Fier, në Shqipëri, të gjenerojë të ardhura, duke mos pasur listë sponsorizimi, kur edhe një mijë lekëshe kur e vë biletën, njerëzit nuk vijnë për të parë një ndeshje basketbolli, dhe ne e kemi lënë pa pagesë atë, dhe gjithë ato pak të ardhura që vijnë, e thashë pak më parë, vijnë nga Akademia jonë që po mundohemi. Është edhe një gjë tjetër, që po mundohemi, se presore Yllka është vetë pjesë e projektit të KOKSH-it, që të paktën, kemi sjellë edhe një projekt të KOKSH-it këtu, që të kemi klasa sportive dhe ekipe sportive që KOKSH-I paguan trajnerët. Edhe janë shifra po të njëjtat me ato që bën KOKSH-I, që po mundohemi të mbajmë të rinjtë tanë afër sportit, por mundohemi me mish e me shpirt që të rinjtë tanë të rrinë afër sportit. Që edhe ata pak të rinj që kemi, mos të ikin, të rrinë afër sportit.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit! Agron shkurtimisht kishe gjë ?

Z.Agron Profka

Kisha dy llafe mqs dolën në pah...ato që nxori Drejtori. Të dashur kolegë duhet të dimë një diçka. Të mbash një ekip sportiv sot në Fier, duhet të bësh sakrificën më të madhe. Unë kam



drejtuar vetë ekipin e basketbollit të meshkujve, dhe tek biznesi mund të kërkosh vetëm një herë, ti shtrishë dorën, më tepër nuk ja shtrinë dot dorën biznesit, se nuk të jep, një herë të jep.

Z.Endri Jaupaj

Kur i lë ndërtuesit atje tek dera 12 vjet pa i afruar, dhe pa i dhënë një projekt, normale që s'të vjen askush.

Z.Melsi Bogdani

Endri nuk jemi tek ndërtimi këtu, jemi tek...të lutem, të lutem, mbarove Gone ?

Z.Endri Jaupaj

Patjetër se janë të lidhura të gjitha, për të gjitha jemi këtu ne.

Z.Agron Profka

O Endri kur kam ardhur tek ty unë s'më ke dhënë një kokërr leku për ekipin e basketbollit, prandaj mos fol shumë.

Z.Endri Jaupaj

Të vë në dijeni që biznesi im është biznes familjar.

Z.Agron Profka

Kam ardhur për ekipin e basketbollit.

Z.Endri Jaupaj

As e mbajë mend që ke ardhur njëherë, dhe gënjen.

Z.Melsi Bogdani

Elvi, Endri dhe Erlinda në emër të grupit mqs Marjusi mungon sot dhe e hedhim në votë.

Z.Elvi Daka

Shkurtimisht dy gjëra. E para faleminderit shumë administratorëve të gjithë gjësë...

Z.Agron Profka

Më fal se unë s'kisha mbaruar por gjith vazhdo...


Z.Melsi Bogdani

Jo thashë se mbarove Gone. Ndjesë.

Z.Elvi Daka

Të kërkojë ndjesë Gone, por unë nuk të ndërhyjë në radhë, kështu që vazhdo.

Z.Agron Profka



Nuk e kam me ty e kam me drejtuesin unë.

Z.Melsi Bogdani

Jo jo thashë se mbarove. Ndjesë, ndjesë. Atëherë vazhdo Gone. Thashë se mbarove.

Z.Agron Profka

Prandaj duhet të dimë shumë sakrificat që bëjnë trajnerët dhe në çdo dëgjese publike ku unë kam marrë pjesë, dëgjojë që të happen sa më shumë fusha sportive sa më shumë. Këto fusha sportive që të hapen nga do ti marrin fondet ? Nga do vijnë këto fonde ? Nga do paguhen këta trajnerë se secili do paret ? Që të vijë një trajner me 300 lekë ora atje, ka një sakrificë të madhe që ne çojmë fëmijët atje, mbajmë në aktivitet sportiv. Po mos të paguhen këta ku do venë këta fëmijë ? Këtë duhet të llogarisim ne, këta fëmijë ku do venë nesër, pasnesër. Po të mbyllet ky klub ? Kështu që duhet t'ja dimë për faleminderit të gjithë pjesëtarëve të klubit sportiv që i mbajnë këto ekipe gjallë, se Fieri do mbarojë dhe ne s'kemi ku të vemi të shikojmë një aktivitet sportiv. Unë them mos ta zgjasim më shumë po ta ngremë në votë pro.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit Gone! Po po. Elvi.

Z.Elvi Daka

Shkurtimisht. Edhe një herë faleminderit Administrator, për të gjithë qartësinë që na dhe lidhur me klubin Shumësportësh. Unë vetë përfaqësoj një ekip futbollit në qytetin e Fierit. E njoh vështirësinë që për momentin po përballet jo vetëm futbollit, por të gjitha sportet në qytetin tonë dhe kjo, me keqardhje e them për të gjithë ne si qytetarë të këtij qyteti, duhet të na vijë turp dhe duhet të na vijë keq, për situatën në të cilën gjendet sporti në Fier. E vetmja pyetje që unë kam është : Krahasimisht duke krahasuar vitin e kaluar, me ndryshimet infrastrukturore që ka pësuar edhe klubi Shumësportësh. Kemi ngritur një qendër për trajtimin e sportistëve. A janë reflektuar këto në kostot apo në uljen e deficitit buxhetor nga viti I shkuar në këtë vit ?

Z.Paljon Zarka

Për kë qendër e ke llafin Elvi ?

Z.Elvi Daka

Është një qendër për trajtimin e sportistëve, ndoshta dhe me ushqim që është tek pallati I supermarketit...


Z.Paljon Zarka

Ë jo qendër, ajo është hoteleri

Z.Elvi Daka

Po hoteleri por...

Z.Paljon Zarka



Ne kemi zbutur goxha kostot sepse sportistët e huaj që vijnë, edhe sportistët e tjerë nga rrethet që kryesisht janë pjesë e ekipeve të para, detyrimisht do të ofrosh akomodimin. Dhe ajo është një ndihmë shumë e madhe, po ta shtosh dhe në kostot, po të paguaje shtëpi me qera, apo hoteleri do të ishte një barrë shumë e madhe për ne dhe unë ju falënderoj të gjithëve sepse, përpara 1 vit e gjysmë e keni marrë atë vendim dhe ajo I ka kaluar klubit në administrim por është pronë e Bashkisë, thjesht për ta përdorur si hoteleri, edhe ajo është një ndihmesë shumë e madhe, dhe mund të them që, pa atë lloj objekti atje, ne do ta kishim shumë të vështirë sot, jetëgjatësinë për të bërë sport në Fier.

Z.Elvi Daka

Sa ka ndryshuar në borxhet e klubit, kjo më intereson, dmth diferenca nga vjet në sivjet, sepse këtu shikohet pastaj edhe...

Z.Melsi Bogdani

Ta tha pra...

Z.Paljon Zarka

Ka dhënë... Tani unë s'mund të japë një shifër të saktë se nuk e kam sot, por mund të them që, nqs ne do të detyroheshim të merrnim dy tre apartamente me qira, sot nuk I marrim më. Kryesisht një apartament shkon 200-300 mijë lekë, plus energjia plus uji, detyrimisht zbuten, I zbut goxha.

Z.Melsi Bogdani

Shumë faleminderit ! Endri dhe Erlinda në emër të grupit mqs mungon Marjusi.

Z.Endri Jaupaj

Ju përgëzojë për punën dhe sinqerisht do të doja që ne të kishim buxhet këtu për të mbuluar edhe dyfishin e asaj që ti na ke sjellë, po qe ne do ti japim prioritet atyre problematikave që i shikojmë më kryesore, siç janë ndihma e menjëhershme që ne nuk e kemi kaluar, dhe po të citoj Kryetarin e Bashkisë, Kryetarin tuaj të Bashkisë, që ka thënë nuk kam fonde.

Z.Paljon Zarka

Kjo është një gjë që duhet t'ja thuash Kryetarit të Bashkisë, nuk duhet të ma thuash mua.

Z.Endri Jaupaj

Dhe e di çfarë do të thotë ndihmë e menjëhershme për njerëz që vuajnë nga sëmundje të pashërueshme, nga historira familjare, nga drama, dhe një Kryetar...

Z.Paljon Zarka

Ç'lidhje kam unë me këto ?

Z.Endri Jaupaj

44

Çfarë marrëdhëniesh ke ti me Kryetarin e Bashkisë ?

Z.Paljon Zarka

Po çfarë të intereson ty, çfarë lidhje ka kjo ?

Z.Endri Jaupaj

Më intereson patjetër. Si i ke marrëdhëniet me Kryetarin e Bashkisë ?

Z.Paljon Zarka

Unë kam një marrëdhënie me Kryetarin e Bashkisë...

Z.Endri Jaupaj

Atëherë unë këtë e marrë shenjë arrogance nga ju, që në 3 vjet, ju po uleni në atë karrige për herë të parë.

Z.Paljon Zarka

Si ?

Z.Endri Jaupaj

Po dhe votën time e ke kundra vetëm për këtë gjë.

Z.Paljon Zarka

Për çfarë ?

Z.Endri Jaupaj

Në 3 vite ke ardhur...Për herë të parë po vjen sot para nesh. Në 3 vjet nuk je ulur asnjëherë në atë karrige. Unë këtë e marrë shenjë arrogance.

Z.Paljon Zarka

Unë thashë se më ka mbuluar Kryetari.

Z.Endri Jaupaj

Vetëm për fotovoltaikë ka këtu, janë vjedhur gjysëm milioni, miliardi euro.

Z.Melsi Bogdani

Endri kur të jetë pika për parqet po. Atëherë, Erlinda dhe e hedhim në votë.

Znj.Erlinda Llupi

Të nderuar kolegë këshilltarë! Në mungesë të Kryetarit të grupit, të këshilltarëve të PS, Z.Marjus Voja, dhe me autorizimin e tij, do të marrë fjalë në emër të grupit për të paraqitur qëndrimin tonë lidhur me këtë çështje. Në mbështetje të materialit të paraqitur, për miratimin e pasqyrave financiare,si dhe duke marrë në analizë raportin e auditimit, konstatohet se audituesi ka

45

evidentuar problematika dhe mangësi të rëndësishme në drejtimin dhe administrimin e shoqërisë, të cilat kanë ndikuar në performancën financiare dhe në garantimin e standarteve të kërkuara të menaxhimit. Megjithëse, për arsye të vazhdimësisë institucionale dhe funksionimit normal të aktivitetit, vlerësojmë miratimin e pasqyrave financiare, çmujmë se gjetjet dhe rezervat e evidentuara në raportin e auditimit, përbëjnë një shqetësim serioz, që kërkon ndërhyrje të menjëhershme. Për sa më sipër, propozojmë që krahas miratimit të pasqyrave financiare, t'i lëmë detyrë ekzekutivit, të marrin masa për rishikimin dhe ndryshimin e kupolës drejtuese të shoqërisë, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë administrative, përmirësimin e menaxhimit financiar dhe garantimin e një administrimi më eficient dhe transparent në vijim. Faleminderit!

Z.Melsi Bogdani

Atëherë, shumë faleminderit ! E hedhim në votë, kush është dakord për miratimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2025 të Shoqërisë, klubi i Shumësportësh Apolonia, duke pasur parasysh dhe rekomandimet e...Kush është dakord ?

Znj.Evis Sema

Nuk jemi për futbollin këtu, dale një çikë, shikoni një çikë...

Z.Paljon Zarka

Po, po, shiko, kjo, kjo gjë, domethënë ne, në qoftë se marrim, të themi, të them...

Z.Endri Jaupaj

Të lutem, të lutem, ta mbarojë votimi, të mbarojë njëherë votimi dhe pastaj.

Z.Paljon Zarka

Jo mo se jemi përpara një fakti shumë të rëndësishëm, se dua ta them këtë. Nqs ne nuk miratojmë pasqyrat financiare sot, shpallim falimentin edhe mbledhim mendjen edhe unë, edhe ne...

Z.Endri Jaupaj

Pse jo ? Pse ç'a ka ? Të shpallet.

Z.Paljon Zarka

Po pra.

Z.Melsi Bogdani

Numëroji votat të lutem !

Z.Endri Jaupaj

Asnjë lloj problemi s'ka.

Z.Paljon Zarka

Për ty, jo. Për ty e di që s'ka asnjë problem se s'ke lidhje fare me sportin.

46

Znj.Evis Sema

Nuk është për Apoloninë e futbollit.

Z.Melsi Bogdani

Endri të lutem bëjmë numërimin e votave. Zana të lutem kartonin !

Znj.Yllka Sheshi

Endri dua të pyes për diçka.

Z.Endri Jaupaj

Fol me Kryetarin, mos fol me mua.

Znj.Yllka Sheshi

Të mendosh për trajnerë që punojnë 6 herë në javë, I bie 7 ditë në javë me ekipin...

Z.Melsi Bogdani

O Yllka, o Yllka të lutem !

Znj.Yllka Sheshi

Është turp.

Z.Armando Çupa

Jemi në proces votimi, ju lutem ngrini kartonat!

Z.Melsi Bogdani

Kush është dakord me miratimin e pasqyrave financiare ?

Z.Armando Çupa

3 vota kundër, 3 abstenime, 30 prezent në sallë.

Z.Endri Jaupaj

Nuk miratohet.

Z.Melsi Bogdani

Edhe një herë, edhe një herë. 3 vota, kundër, 3 abstenime, 30 prezent në sallë, nuk miratohet.

Pro 24 vota

Kundra 3 vota

Abstenim 3 vota

Nuk miratohet.

Z.Paljon Zarka

Ore është turp, ju jeni ata që para një mbledhje, nxorët pretendimin për Apolloninë...

Endri Jaupaj

Turp të ketë Kryetari jotë që la ...

Z.Paljon Zarka

Kryetari kur të vijë...Ju jeni njerëzit që doni sportin, ju jeni njerëzit që doni zhvillimin, ju jeni njerëzit...

Z.Endri Jaupaj

Turp të kesh ti...

Z.Paljon Zarka

Kjo ishte turp për Ps.

Z.Melsi Bogdani

Nuk ka diskutime sot.Shumë faleminderit ! Takohemi në mbledhjen e radhës!

Ky procesverbal ka 48 (dyzet e tetë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Çupa

Kryetar i Këshillit

Melsi Bogdani

